



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 24.09.2024)

Pika 1 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e listës së gjyqtarëve që kanë ose mund të kenë dy vlerësime, një vlerësim, si dhe të gjyqtarëve që nuk kanë e nuk mund të kenë asnjë vlerësim, për efekt të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, të shpallura me vendimet e këshillit të lartë gjyqësor nr.489, nr.490, nr.491 nr.492 dhe nr.493 datë 13.09.2024”, i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale (relatore znj. Irena Plaku).¹

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:14 dhe mbaroi në orën 15:08.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 3. Irena Plaku | (anëtare) |
| 4. Gentiana Muçaj | (anëtare) |
| 5. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 6. Bledar Bajri | (anëtar) |

¹ Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e 7-ta sipas rendit të ditës.

7. *Albens Tabaku* (anëtar)
8. *Markelian Koça* (anëtar)
9. *Yllka Rupa* (anëtare)

Shënim: Nuk morën pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor *znj. Naureda Llagami*, si dhe anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Emona Muçi*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
2. *Luan Dibra, Gentiana Agushi, Maela Alicanaj, Rezarta Taushani, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
3. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.*
4. *Petrika Thano, MCA-PRESS.*
5. *Sidorela Driçi, AIS Instituti Shqiptar i Shkencës, Open Data.*
6. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

1. Shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e listës së gjyqtarëve që kanë ose mund të kenë dy vlerësime, një vlerësim, si dhe të gjyqtarëve që nuk kanë e nuk mund të kenë asnjë vlerësim, për efekt të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, të shpallura me vendimet e këshillit të lartë gjyqësor nr.489, nr.490, nr.491 nr.492 dhe nr.493 datë 13.09.2024”, i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale (relatore *znj. Irena Plaku*).

Ilir Rusi: Përhëndetje të nderuar anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Sipas njoftimit të bërë, deklaroj të hapur mbledhjen e ditës së sotme.

Ju bëj me dije që Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor për arsye objektive nuk

mund të jetë prezent në këtë mbledhje. Gjithashtu edhe zonja Muçi nuk mund të jetë prezent në këtë mbledhje.

Për shkak të krijimit të kuorumit të nevojshëm, mbledhjen e deklaroj të hapur dhe në vijim do drejtohet nga unë Ilir Rusi, Zëvendëskryetar i Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Në lidhje me rendin e ditës, keni ndonjë diskutim mbi kronologjinë e shqyrtimit të çështjeve?

Po, zoti Kurushi!

Klodian Kurushi: Faleminderit zoti Kryetar!

Unë kam një propozim për të ndryshuar rendin e ditës në pozicionet se si janë përcaktuar çështjet.

Unë mendoj, meqenëse çështja e miratimit të listës së gjyqtarëve që kanë ose që mund të kenë dy vlerësime, relacioni dhe projektvendimi i sjellë nga Komisioni i Vlerësimit Etik dhe Veprimtarisë Profesionale, për efekt edhe të zinxhirit të relacioneve dhe veprimtarisë pasuese që do ta ndjekin këtë relacion nga ana e Këshillit, unë mendoj që kjo të përfshihet në rend të ditës si çështja e parë që ta shqyrtojë Këshilli. Më pas, do na japë edhe ne kohë dhe mundësi për të sjellë relacionet pasuese që kanë lidhje me këtë relacion që ka paraqitur sot Komisioni i Vlerësimit Etik dhe Veprimtarisë Profesionale.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Kurushi!

Ka diskutime të tjera?

Jeni dakord me propozimin?

Jeni dakord me propozimin e zotit Kurushi?

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Bledar Bajri: Dakord.

Albens Tabaku: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Ilir Rusi: Atëherë, fillojmë këtë mbledhje si pikë të parë tashmë shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e listës së gjyqtarëve që kanë ose mund të kenë dy vlerësime, një vlerësim, si dhe të gjyqtarëve që nuk kanë e nuk mund të kenë asnjë vlerësim, për efekt të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, të shpallura me vendimet e këshillit të lartë gjyqësor nr.489, nr.490, nr.491 nr.492 dhe nr.493 datë 13.09.2024”, për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, për më tej fjalën relatores znj. Plaku.

Irena Plaku: Atëherë, po ju parashtroj në mënyrë të përmbledhur relacionin mbi projektvendimin për miratimin e listës së gjyqtarëve që kanë ose mund të kenë dy vlerësime, një apo asnjë vlerësim.

Këshilli i Lartë Gjyqësor me vendimet nr.489, deri në vendimin nr.493 datë 13.09.2024 ka hapur 5 (pesë) procedura për lëvizje paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, konkretisht në 5 (pesë) pozicione të përhershme, 3 (tre) pozicione në fushën penale dhe 2 (dy) pozicione në fushën civile

Si kandidatë, siç janë përcjellë nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës janë 26 kandidatë të cilët janë cituar në projektraport. Duke filluar me:

1. {...};
2. {...};
3. {...};
4. {...};
5. {...};
6. {...};
7. {...};
8. {...};
9. {...};
10. {...};

11. {...};
12. {...};
13. {...};
14. {...};
15. {...};
16. {...};
17. {...};
18. {...};
19. {...};
20. {...};
21. {...};
22. {...};
23. {...};
24. {...};
25. {...};
26. {...}.

Në zbatim të nenit 43 të ligjit “Për statusin”, i ndryshuar si dhe vendimit nr. 320 datë 17.09.2020 “Për kriteret dhe procedurat e lëvizjes paralele të gjyqtarëve”, faza e parë e procedurës së lëvizjes paralele, për çdo pozicion të lirë të shpallur, fillon për gjyqtarët kandidatë që kanë apo mund të kenë dy vlerësime etike profesionale. Në rast se për pozicionin konkret nuk ka kandidatë të tillë, ata janë tërhequr nga kandidimi ose janë skualifikuar për mosplotësim kushtesh, procedura e lëvizjes paralele vazhdon me kandidatët që kanë ose mund të kenë një vlerësim, dhe më pas në rast se nuk ka kandidatë të kësaj kategorie, kalon tek gjyqtarët të cilën nuk kanë asnjë vlerësim. e në mungesë edhe të këtyre të fundit, vijon me kandidatët që nuk kanë asnjë vlerësim. Për të bërë të mundur në veçanti gjyqtarët që “mund të kenë 2 vlerësime, 1 vlerësim, ose nuk mund të kenë asnjë vlerësim”, në pikën 9 të çdo vendimi hapje procedure lëvizje paralele, është parashikuar se: “Pas përfundimit të afatit të kandidimit, sipas pikës 3 të vendimit, mbi propozimin e Komisionit të Vlerësimit Etik dhe Profesional, Këshilli miraton me vendim listën e kandidatëve që kanë ose mund të kenë dy vlerësime.

Bazuar sa më sipër, Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, pasi verifikoi përvojën profesionale të secilit nga gjyqtarët kandidatë si më sipër dhe ecurinë e procedurave të vlerësimit etik dhe profesional për secilin prej tyre, sipas Skemës së Re të Vlerësimit, vlerësime të mbaruara, atyre në proces të filluara ose që mund të fillonin sipas programit të vlerësimeve të miratuara nga Këshilli gjatë kësaj periudhe. Për t'i vlerësuar këto është mbajtur parasysh:

- Mundësia e pasjes së dy vlerësimeve apo të një vlerësimi, evidentohet referuar programeve të vlerësimeve të miratuara nga Këshilli, pjesë e të cilëve janë: gradimet; vlerësimet periodike 3-vjeçare si dhe vlerësimet e përshpejtuara në rastet kur gjyqtarët kandidojnë për lëvizje paralele. Hapja e procedurave për lëvizje paralele nuk nënkupton dhe as kërkon sipas ligjit miratimin e programeve të posaçme të vlerësimit;

- Referuar neneve 43 dhe 84 të ligjit "Për statusin", si dhe vendimit të KLGJ nr. 320, gjyqtarët që kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar dhe që gjatë kësaj periudhe kanë më shumë se 1 vit punë si gjyqtar, vlerësimi i parë konsiderohet ai i gradimit. Për këta gjyqtarë, për efekt të pasjes së dy vlerësimeve, vlerësimi i përshpejtuar i detyruar për vitin 2023, si vlerësim i dytë për efekt të procedurës së lëvizjes paralele, do të fillojë vetëm nëse ata janë përfshirë në programet e vlerësimit 2017-2019, 2020-2022, dhe 2021-2023;

- Për gjyqtarët që e kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar, që gjatë periudhës kanë më pak se 1 vit punë si gjyqtar, vlerësimi i parë konsiderohet ai periodik 3-vjeçar i filluar ose që mund të fillojë sipas programeve të vlerësimeve të miratuara nga Këshilli;

- Për gjyqtarët që nuk e kanë kaluar procesin e rivlerësimit kalimtar, por që nuk janë përfshirë në programin e vlerësimeve të miratuar nga Këshilli, gradimi nuk mund të realizohet, prandaj për këta gjyqtarë vlerësim i parë do të konsiderohet vlerësimi i fundit etik dhe profesional që ka qenë në fuqi përpara Ligjit për Statusin. Për këta gjyqtarë vlerësim i dytë do të konsiderohet vlerësimi i përshpejtuar i detyruar për vitin 2023;

- Për gjyqtarët që nuk e kanë kaluar procesin e rivlerësimit kalimtar dhe që nuk kanë asnjë vlerësim etik dhe profesional sipas rregullave që kanë qenë në fuqi përpara Ligjit për Statusin, por që janë përfshirë në programin e vlerësimeve të miratuar nga Këshilli, gradimi nuk mund të realizohet, prandaj vlerësimi i parë do të konsiderohet ai

periodik, sipas programit të vlerësimeve të miratuar nga Këshilli për vitin 2021, 2023 dhe 2024. Për gjyqtarët e përfshirë në programin e vlerësimeve 2017-2019 apo ato të përfshirë në vitin 2018-2020, vlerësim i dytë do të konsiderohet vlerësimi i përshpejtuar i detyruar për vitin kalendarik 2023, vlerësim që Këshilli e ka marrë përsipër ta kryejë në rastet kur kandidohet për lëvizje paralele. Por ky i fundit do të konsiderohet i mundshëm për tu kryer vetëm në rastin kur kanë kaluar më shumë se 2 vjet nga vlerësimi i fundit, në këtë rast nga viti 2019 apo 2020;

- Për gjyqtarët e emëruar nga KLGJ, për të cilët verifikimi i pasurisë e figurës është bërë prej tij, vlerësim i parë etik-profesional i mundshëm për t'u kryer, do të konsiderohet ai i parashikuar në programin e vlerësimit për vitin 2023 dhe 2024.

Bazuar në kriteret e mësipërme, konstatohet si më poshtë:

Për gjyqtarin {...} (*lapsus*, {...}), nuk mund të ketë asnjë vlerësim, pasi nuk ka plotësuar përvojën profesionale 3-vjeçare.

Për gjyqtarin {...}, nuk mund të ketë asnjë vlerësim, pasi edhe për këtë gjyqtar nuk është plotësuar përvoja profesionale prej 3 vitesh.

Për gjyqtarin {...}, për të mund të ketë një vlerësim, pasi si është përfshirë në programin e vlerësimit 3-vjeçar pasi ka plotësuar përgjatë vitit 2022 periudhën e vjetërsisë së tij në punë prej 3 vjetësh. Gjithashtu Këshilli i Lartë Gjyqësor, me vendimin nr. 183, ka miratuar raportin e vlerësimit përfundimtar për periudhën e vlerësimit 2020-2022.

Për gjyqtaren {...}, nuk mund të ketë asnjë vlerësim, pasi nuk ka plotësuar ende përvojën profesionale prej 3 vjetësh.

Për gjyqtarin {...}, gjyqtar i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Mat, i emëruar gjyqtar në datën 24.11.1993, gradimi nuk mund të realizohet, pasi sipas këtij vendimi gjyqtari me vendim të ndërmjetëm nr.5, të datës 24.07.2020 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit i është dhënë masa disiplinore e pezullimit nga detyra për një periudhë 1-vjeçare për të ndjekur programin e trajnimit, sipas kurikulave të miratuara nga Shkolla e Magjistraturës. Ky vendim i paankimueshëm e bën të pamundur realizimin e procesit të vlerësimit të gradimit për periudhën 2013-2016 nga organi kushtetues që e ka këtë kompetencë, është vlerësuar se nuk ka arritur nivelin minimal profesional, mbi të cilin Këshilli mund të përcaktojë gradimin. Ky

7

vlerësim i KPK-së për efekt të nivelit të vlerësimit konsiderohet sipas ligjit “Për statusin” i pamjaftueshëm. Nga ana tjetër vlerësimi i fundit etik dhe profesional që ky gjyqtar ka pasur para hyrjes në fuqi të ligjit “Për statusin” është ai i miratuar me vendimin me nr. 110/2, datë 13.11.2015 të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë për periudhën e vlerësimit 2007-2009 me nivelin “shumë mirë”.

Për këtë gjyqtar, pas periudhës 2021, kur është miratuar vendimi për konfirmimin e tij në detyrë dhe nga Shkolla e Magjistraturës është vlerësuar “Mirë”, nuk mund të ketë vlerësim tjetër gjatë kësaj periudhe, të përshpejtuar, pasi nuk kanë kaluar dy vjet nga vlerësimi i fundit. Për këtë arsye, për këtë gjyqtar do konsiderohet se ka dy vlerësime, duke marrë vlerësimin e Shkollës së Magjistraturës “Mirë” dhe atë të kryer nga ish-KLD-ja.

Për gjyqtarin {...}, gjyqtar i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës, i emëruar në datën 09.01.2020, mund të ketë vetëm një vlerësim etik–profesional, pasi gjyqtari ka 3 vjet përvojë profesionale, të plotësuar gjatë vitit 2022. Ky gjyqtar është pjesë e programit të vitit 2020-2022 dhe për të ka filluar procedura e vlerësimit. Ky gjyqtar ka qenë i komanduar në Ministrinë e Drejtësisë me vendim nr.538, datë 14.12.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, me afat komandimi deri në datën 01.01.2028, komandim që është ndërprerë nga Këshilli me vendimin me nr.107, datë 29.02.2024. Sa i përket periudhës së vlerësimit, ky gjyqtar mund të ketë vetëm një vlerësim, pasi periudha e transferimit apo komandimit nuk mund të bëhet një vlerësim i dytë i përshpejtuar, pasi nuk kanë kaluar dy vjet nga vlerësimi i fundit i periudhës së vlerësimit që është 2020-2022.

Për gjyqtarin {...}, mund të ketë vetëm një vlerësim pasi e ka plotësuar përvojën 3-vjeçare profesionale në vitin 2022. Me vendimin nr. 356, datë 11.07.2024, Këshilli ka miratuar raportin e vlerësimit etik dhe profesional për vitin 2020-2022.

Për gjyqtaren {...}, kjo e fundit nuk ka përvojë profesionale 3-vjeçare, si e tillë nuk mund të ketë asnjë vlerësim.

Për gjyqtarin {...}, ky i fundit është emëruar në detyrë në datë 09.01.2020, mund të ketë vetëm një vlerësim etik–profesional, dhe ky është pjesë e programit të vlerësimit etik dhe profesional të miratuar për vitin 2024.

Për gjyqtaren {...}, për të nuk mund të ketë asnjë vlerësim pasi kjo gjyqtare nuk ka plotësuar ende përvojën profesionale 3-vjeçare.

Për gjyqtaren {...}, kjo e fundit ka 3 vjet përvojë profesionale, të plotësuar përgjatë vitit 2022. Është pjesë e programit të vlerësimit për vitin 2024 dhe për të ka filluar procedura e vlerësimit etik dhe profesional.

Për gjyqtarin {...}, gjyqtar i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, aktualisht i caktuar përkohësisht në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, është emëruar në korrik 2022, dhe për të nuk ka mundësi vlerësimi pasi nuk ka plotësuar përvojën profesionale 3-vjeçare.

Për gjyqtaren {...}, gjyqtare e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, aktualisht është e komanduar në Gjykatën e Lartë, mund të ketë një vlerësim etik-profesional, pasi e ka plotësuar përvojën profesionale 3-vjeçare në vitin 2023. Kjo gjyqtare është pjesë e programit të vlerësimit për 2024 dhe për të ka filluar procedura e vlerësimit me vendim të Këshillit.

Për gjyqtarin {...}, mund të ketë dy vlerësime dhe këtij gjyqtari i kanë përfunduar të dy vlerësimet. Me vendimin nr. 481, të datës 13.09.2023, për periudhën 2017-2019 dhe me vendimin nr. 486, të datës 21.09.2023 Këshilli ka miratuar vlerësimin etik dhe profesional të përshpejtuar të detyruar për vitin 2022, që konsiderohet edhe vlerësimi i dytë.

Për gjyqtarin {...}, nuk mund të ketë asnjë vlerësim, pasi nuk ka plotësuar ende përvojën profesionale.

Për gjyqtarin {...}, gjyqtar i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, aktualisht i komanduar në Gjykatën Evropiane të Drejtave të Njeriut, mund të ketë vetëm një vlerësim etik-profesional, pasi ka plotësuar përvojën profesionale, të plotësuar përgjatë vitit 2023. Ky gjyqtar është pjesë e programit të vlerësimit të miratuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe për të ka filluar procedura e vlerësimit.

Për gjyqtaren {...}, e emëruar më datë 31.10.2014. për të është vendosur mosfillimi për periudhën e gradimit 2013-2016, megjithëse kjo e fundit ka kaluar procesin e rivlerësimit për shkak se nuk kishte më shumë se një vit përvojë profesionale gjatë kësaj periudhe. Kjo gjyqtare është përfshirë në programin e vlerësimit 2017-2019

dhe aktualisht është në procedurën e vlerësimit, vlerësim ky që do konsiderohet vlerësim i parë për efekt të lëvizjes paralele. Gjithashtu, për këtë gjyqtare, sipas programit të vlerësimeve të miratuar nga Këshilli për vitin 2023, ka filluar vlerësimi i dytë i përshpejtuar për vitin kalendarik 2022, pasi ka aplikuar më parë për ngritje në detyrë. Prandaj për këtë gjyqtare do të ketë 2 (dy) vlerësime.

Për gjyqtaren {...}, nuk mund të ketë asnjë vlerësim, pasi nuk ka plotësuar ende përvojën 3-vjeçare.

Për gjyqtaren {...}j, aktualisht e komanduar në Inspektorin e Lartë të Drejtësisë, mund të ketë vetëm një vlerësim etik-profesional, pasi ka përvojën profesionale 3-vjeçare, të plotësuar në vitin 2023. Për këtë gjyqtare ka filluar edhe procedura e vlerësimit.

Për gjyqtaren {...}, edhe për këtë të fundit ka filluar vlerësimi etik dhe profesional dhe mund t'i bëhet vetëm një vlerësim pasi përvojën profesionale e ka plotësuar në vitin 2023.

Për gjyqtarin {...}, mund të ketë vetëm një vlerësim etik-profesional, pasi ka 3 vjet përvojë profesionale të plotësuar përgjatë vitit 2023. Ky gjyqtar është pjesë e programit të vlerësimit për vitin 2024 dhe për të ka filluar procedura e vlerësimit.

Për gjyqtaren {...}, është emëruar gjyqtare në datën 25.07.2022, nuk mund të ketë asnjë vlerësim, pasi nuk ka plotësuar ende përvojën profesionale.

Për gjyqtaren {...}, kjo e fundit mund t'i bëhet një vlerësim pasi ka periudhën 3-vjeçare profesionale, të plotësuar përgjatë vitit 2022 dhe për të ka filluar procedura e vlerësimit për periudhën 2020-2022.

Për gjyqtarin {...}, edhe për të mund të ketë një vlerësim etik dhe profesional pasi ka plotësuar përvojën 3-vjeçare profesionale, të plotësuar përgjatë vitit 2022. Është pjesë e programit për vitin 2023 dhe për të ka filluar procedura e vlerësimit për periudhën 2020-2022.

Për gjyqtarin {...}, i emëruar gjyqtar në datën 21.10.2013, gradimi si vlerësim i parë nuk mund të realizohet, në kushtet kur vendimi i KPK (po e them shkurt) për konfirmimin e tij në detyrë është ankimuar nga Komisioneri Publik në Kolegjin e Posaçëm të Apelit, e si i tillë nuk ka marrë formë të prerë. Ky gjyqtar është përfshirë në programin e vlerësimit 2017-2019 dhe për të ka filluar procedura e vlerësimit për

këtë periudhë. Për këtë gjyqtar mund të fillojë vlerësimi i përshpejtuar i detyruar për vitin 2023, sepse ai ka punuar përgjatë këtij viti nga 1 janari 2023 deri në 31.01.2023, si gjyqtar i Skemës së Delegimit dhe prej datës 01.02.2023 si gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër. Prandaj për këtë gjyqtar mund të ketë 2 (dy) vlerësime.

Për gjyqtarin {...}, edhe për të mund të ketë dy vlerësime pasi vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit ka marrë formë të prerë. Në këto kushte mund t'i bëhet periudha e vlerësimit 2013-2016 (periudha e gradimit). Gjithashtu ai është pjesë e programit të vlerësimit dhe për të ka filluar procedura e vlerësimit për vitin 2017 – 2019. Në fakt është përfunduar projektraporti dhe i ka kaluar mbledhjes plenare.

Për sa më sipër, në pikën 1 të projektvendimit është parashikuar miratimi nga Këshilli i listës së gjyqtarëve që kanë ose mund të kenë dy vlerësime, për efekt të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, të shpallura me vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr.489, nr.490, nr.491 nr.492 dhe nr.493, datë 13.09.2024, sipas Shtojcës I të këtij projektvendimi, ku përmban listën e gjyqtarëve që kanë dy vlerësime, konkretisht {...}, {...}. Listën e gjyqtarëve që mund të kenë 2 (dy) vlerësime: {...}, {...} dhe {...}.

Në pikën 2 është parashikuar miratimi nga Këshilli i listës së gjyqtarëve që kanë ose mund të kenë një vlerësim për efekt të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele, sipas Shtojcës II. Në këtë shtojcë është parashikuar lista e gjyqtarëve që kanë një vlerësim: {...} dhe {...}. Dhe më poshtë është lista e gjyqtarëve që mund të kenë 1 (një) vlerësim (pra nuk i është bërë vlerësimi por e kanë të mundur kryerjen e një vlerësimi), konkretisht: {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}.

Ndërsa në pikën 3 të projektvendimit është parashikuar miratimi i listës së gjyqtarëve që nuk kanë dhe nuk mund të kenë asnjë vlerësim. Konkretisht janë: {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}.

Në projektvendim përcaktohet dhe hyrja në fuqi me botimin në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zonja Plaku!

Ka diskutime për sa u parashtrua?

Meqenëse nuk ka diskutime, hedhim në votim projektvendimin përkatës.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Bledar Bajri: Dakord.

Albens Tabaku: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për miratimin e listës së gjyqtarëve që kanë ose mund të kenë dy vlerësime, një vlerësim, si dhe të gjyqtarëve që nuk kanë e nuk mund të kenë asnjë vlerësim, për efekt të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, të shpallura me vendimet e këshillit të lartë gjyqësor nr.489, nr.490, nr.491 nr.492 dhe nr.493, datë 13.09.2024”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse vendosi miratimin e kësaj liste, listë e cila është sipas relacionit të prezantuar nga zonja Plaku.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me botimin në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 1 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 24.09.2024)

Pika 2 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, të shpallur me vendimin nr. 260 datë 16.05.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor për kandidatët që nuk kanë dhe nuk mund të kenë asnjë vlerësim”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, relator z. Klodian Kurushi.²

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:14 dhe mbaroi në orën 15:08.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. <i>Ilir Rusi</i> | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| 2. <i>Klodian Kurushi</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 3. <i>Irena Plaku</i> | <i>(anëtare)</i> |
| 4. <i>Gentiana Muçaj</i> | <i>(anëtare)</i> |
| 5. <i>Ridvan Hado</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 6. <i>Bledar Bajri</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 7. <i>Albens Tabaku</i> | <i>(anëtar)</i> |

² Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e para sipas rendit të ditës.

8. *Markelian Koça* (anëtar)
9. *Yllka Rupa* (anëtare)

Shënim: Nuk morën pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor *znj. Naureda Llagami*, si dhe anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Emona Muçi*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Blertha Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
2. *Luan Dibra, Gentiana Agushi, Maela Alicanaj, Rezarta Taushani, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
3. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.*
4. *Petrika Thano, MCA-PRESS.*
5. *Sidorela Driçi, AIS Instituti Shqiptar i Shkencës, Open Data.*
6. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

2. Shqyrtimi i projektvendimit “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, të shpallur me vendimin nr. 260 datë 16.05.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor për kandidatët që nuk kanë dhe nuk mund të kenë asnjë vlerësim”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, relator z. Klodian Kurushi.

Ilir Rusi: Vazhdojmë me një pikë tjetër të këtij rendi dite, që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, të shpallur me vendimin nr. 260 datë 16.05.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor për kandidatët që nuk kanë dhe nuk mund të kenë asnjë vlerësim”, për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës

dhe relator është z. Kurushi. Do i kërkoja zotit Kurushi, për shkak edhe të intensitetit që kemi në këtë mbledhje, do doja të ishte sintetik në prezantimin e relacionit.

Klodian Kurushi: Faleminderit zoti Rusi!

Të nderuar kolegë!

Paraqesim projektvendimin e radhës “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, të shpallur me vendimin nr. 260 datë 16.05.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Këshilli me vendimin nr. 260, të datës 24.06.2024, hapi procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan (*zoti Kurushi relaton Berat gjatë leximit*).

Afati i kandidimit për lëvizjes paralele u përcaktua deri më datë 30.05.2024.

Kandidatët që aplikuan për pozicionin nr. 260 në atë kohë ishin: znj. {...}, z. {...} dhe z. {...}.

Këshilli me vendimin nr. 297, datë 05.06.2024, miratoi listën e kandidatëve që kanë ose mund të kenë dy vlerësime, 1 vlerësim dhe pa vlerësim.

Në vijim, duke qenë se në pozicionin nr.260, kishte kandidatë me 1 (një) vlerësim (znj. {...}) me Vendimin nr. 298, datë 05.06.2024, “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit”, filloi procesi i kandidimit për zonjën {...} që kishte një vlerësim.

Më tej, Këshilli, me vendimin e përmendur më lart, vendosi fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore fillimisht për zonjën {...} që kishte mundësi t’i bëhej një vlerësim.

Gjatë procedurës së trajtimit të kriterëve formale për kandidaten znj. {...}, me anë të një komunikimi elektronik të paraqitur nga kandidatja më datë 07.07.2024 ajo paraqiti kërkesë për heqjen dorë nga kandidimi për procedurën e lëvizjes paralele për pozicionin e lirë në fushën e së drejtës civile. Pas kërkesës për heqje dorë Këshilli me vendimin nr. 398, datë 30.07.2024, vendosi: “Përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, për pozicionin nr.

260, datë 16.05.2024, për kandidaten znj. {...}, për shkak të tërheqjes nga kandidimi”. Në 30 korrik të 2024.

Siç u përshkrua edhe në hyrje të këtij relacioni, përveç zonjës {...} kandiduan edhe zotërinjtë: z. {...} dhe z. {...} dhe që në kandidim kanë mbetur vetëm këta dy zotërinjtë.

Tani do fillojë procedura për verifikimin e kriterëve ligjore për dy kandidatët e tjerë, pasi zonja {...} që mund t’i bëhej një vlerësim, u tërhoq nga kandidimi.

Lidhur me verifikimin e kandidatëve që kandidojnë për lëvizjen paralele, Këshilli ka miratuar procedura të detajuara përmes vendimit të tij nr. 320, datë 17.09.2020.

Procedurat janë të inkuorpuara, nuk po i lexoj një nga një në këtë pjesë.

Pra Shtojca numër 3, pasi kemi marrë edhe relacionin përkatës nga Komisioni i Vlerësimit Etik dhe Veprimtarisë Profesionale, kemi inkuorpuar edhe listën e gjyqtarëve që nuk kanë dhe që nuk mund të kenë asnjë vlerësim gjatë procedurës së kandidimit të tyre në lëvizjen paralele në pozicionin nr. 260 të vitit 2024, të shpallur me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Ndër këta kandidatë janë z. {...}, gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër; znj. {...}, gjyqtare në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier; z. {...}, gjyqtar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Lushnje; z. {...}, gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan; znj. {...}, gjyqtare në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë; znj. {...}, gjyqtare në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës; znj. {...}, gjyqtare në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier; znj. {...}, gjyqtare në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Lushnje; z. Nertil Dushku, gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier; z. {...}, gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër; z. {...}, gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier dhe znj. {...}, gjyqtare në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës.

Nga lista e gjyqtarëve të përfshirë në Shtojcën III, rezultojnë se 2 (dy) prej tyre kanë kandiduar për pozicionin nr. 260. Janë kandidatët që unë i përmenda më lart.

Në këto kushte, në përputhje me pikën 11 të vendimit, nr. 260, datë 16.05.2024, vendimin nr. 320, datë 17.09.2020, “Për kriteret dhe procedurat e lëvizjes paralele të

gjqtarëve”, Komisioni në këtë rast i propozon Këshillit të miratojë projektvendimin për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, të shpallur me vendimin nr. 260/2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidatët që nuk kanë dhe që nuk mund të kenë vlerësim, pasi këta janë kandidatët e vetëm në këtë pozicion.

Në pikën e dytë parashikohet një rregullim i veçantë mbi caktimin e relatorit për këta 2 (dy) kandidatë. Mbajtur në vëmendje ngarkesën e anëtarëve të Komisionit, ne si Komision propozojmë që relator për të dy kandidatët të jetë z. Albens Tabaku. Pra janë kandidatë për të cilët do fillojë procedura e verifikimit të kriterëve ligjore (që janë tre kriteret ligjore).

Projektvendimi është i strukturuar dhe i propozuar në dy pika, që është bashkëlidhur këtij relacioni dhe ndodhet përpara të gjithë anëtarëve dhe nuk po i lexoj për efekt kohe.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Kurushi!

Ka diskutime për sa u parashtrua?

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me votimin e projektvendimit.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Bledar Bajri: Dakord.

Albens Tabaku: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord (e ripërsërit votën.)

Vendim “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të

Përgjithshëm Elbasan, të shpallur me vendimin nr. 260 datë 16.05.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor për kandidatët që nuk kanë dhe nuk mund të kenë asnjë vlerësim”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse vendosi sipas relatimit të z. Kurushi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në fazën zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 2 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 24.09.2024)

Pika 3 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimeve të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi):

3.1 “Për një ndryshim në vendimin nr. 264, datë 24.05.2024 “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kandidatëve për në formimin fillestar për magjistrat, profili gjyqtar, në Shkollën e Magjistraturës, për vitin akademik 2024-2025”, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

3.2 “Për një ndryshim në vendimin nr. 266, datë 24.05.2024 “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 247, datë 02.05.2024 dhe Gjykatën e Apelit të juridiksionit të përgjithshëm për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile të shpallura me vendimet nr. 244, 245, 246 datë 02.05.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

3.3 “Për një ndryshim në vendimin nr. 57, datë 07.02.2024 “për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile të shpallura me vendimet nr. 239, 240, 241, 242, 243, 244, 245, 246 dhe nr. 247 datë 24.05.2023 dhe Gjykatën Administrative të Apelit për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr. 235, 236, 237 dhe 238 datë 24.05.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

3.4 “Për një ndryshim në vendimin nr. 66, datë 09.02.2023 “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në: Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionet

19

***Mbledhje e Këshillit të Lartë Gjyqësor
Tiranë, më 24.09.2024 (Pika 3)***

e lira të shpallura me vendimet nr.499, nr.500, 501, datë 21.11.2022; si edhe në Gjykatat e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale të shpallura me vendimet nr. 502, nr.503, 504 datë 21.11.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

3.5 “Për një ndryshim në vendimin nr. 298, datë 05.06.2024 “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan/ Durrës/Tiranë/ dhe Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, të shpallura me vendimet nr. 233, 234, 235, 236, 237, 238, 239, 240, 242, 243, datë 02.05.2024 dhe nr. 260, datë 16.05.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

3.6 “Për një ndryshim në vendimin nr. 294, datë 30.05.2023 “Për fillimin e procedurave të përzgjedhjes së kandidatëve për lëvizje paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë e Durrës për pozicionet e shpallura të lira, përkatësisht me vendimet nr. 11; 12; 13; 14; 15; 16; 17; 18; 19; 20; 21 dhe 24, datë 18.01.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

3.7 “Për një ndryshim në vendimin nr. 230, datë 26.04.2024 “Për fillimin e procedurave të përzgjedhjes të kandidatëve për lëvizje paralele në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr. 256, 257 dhe 258 datë 24.05.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

3.8 “Për një ndryshim në vendimin nr. 205, datë 17.04.2024 “Për fillimin e procedurave të përzgjedhjes të kandidatëve për lëvizje paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, Durrës dhe Tiranë për pozicionet e shpallura të lira, përkatësisht me vendimet nr. 249, datë 24.05.2023; nr. 22, nr. 23 datë 18.01.2023 dhe nr. 73, 74, 75, 76, 77, 78, 79, 80, 81, 82, 83, 84,85 dhe 86 datë 20.02.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.³

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:14 dhe mbaroi në orën 15:08.

³ Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e dyta sipas rendit të ditës.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. *Ilir Rusi* (zëvendëskryetar)
2. *Klodian Kurushi* (anëtar)
3. *Irena Plaku* (anëtare)
4. *Gentiana Muçaj* (anëtare)
5. *Ridvan Hado* (anëtar)
6. *Bledar Bajri* (anëtar)
7. *Albens Tabaku* (anëtar)
8. *Markelian Koça* (anëtar)
9. *Yllka Rupa* (anëtare)

Shënim: Nuk morën pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor *znj. Naureda Llagami*, si dhe anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Emona Muçi*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
2. *Luan Dibra, Gentiana Agushi, Maela Alicanaj, Rezarta Taushani, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
3. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.*
4. *Petrika Thano, MCA-PRESS.*
5. *Sidorela Driçi, AIS Instituti Shqiptar i Shkencës, Open Data.*
6. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

3. Shqyrtimi i projektvendimeve të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi):

3.1 “Për një ndryshim në vendimin nr. 264, datë 24.05.2024 “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kandidatëve për në formimin fillestar për magjistrat, profili gjyqtar, në

Shkollën e Magjistraturës, për vitin akademik 2024-2025”, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

3.2 “Për një ndryshim në vendimin nr. 266, datë 24.05.2024 “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaqme për Korrupsioni dhe Krimin e Organizuar për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 247, datë 02.05.2024 dhe Gjykatën e Apelit të juridiksionit të përgjithshëm për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile të shpallura me vendimet nr. 244, 245, 246 datë 02.05.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

3.3 “Për një ndryshim në vendimin nr. 57, datë 07.02.2024 “për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile të shpallura me vendimet nr. 239, 240, 241, 242, 243, 244, 245, 246 dhe nr. 247 datë 24.05.2023 dhe Gjykatën Administrative të Apelit për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr. 235, 236, 237 dhe 238 datë 24.05.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

3.4 “Për një ndryshim në vendimin nr. 66, datë 09.02.2023 “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në: Gjykatën e Posaqme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr.499, nr.500, 501, datë 21.11.2022; si edhe në Gjykatat e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale të shpallura me vendimet nr. 502, nr.503, 504 datë 21.11.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

3.5 “Për një ndryshim në vendimin nr. 298, datë 05.06.2024 “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan/ Durrës/Tiranë/ dhe Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, të shpallura me vendimet nr. 233, 234, 235, 236, 237, 238, 239, 240, 242, 243, datë 02.05.2024 dhe nr. 260, datë 16.05.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

3.6 “Për një ndryshim në vendimin nr. 294, datë 30.05.2023 “Për fillimin e procedurave të përzgjedhjes së kandidatëve për lëvizje paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë e Durrës për pozicionet e shpallura të lira,

përkatësisht me vendimet nr. 11; 12; 13; 14; 15; 16; 17; 18; 19; 20; 21 dhe 24, datë 18.01.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

3.7 “Për një ndryshim në vendimin nr. 230, datë 26.04.2024 “Për fillimin e procedurave të përzgjedhjes të kandidatëve për lëvizje paralele në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr. 256, 257 dhe 258 datë 24.05.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

3.8 “Për një ndryshim në vendimin nr. 205, datë 17.04.2024 “Për fillimin e procedurave të përzgjedhjes të kandidatëve për lëvizje paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, Durrës dhe Tiranë për pozicionet e shpallura të lira, përkatësisht me vendimet nr. 249, datë 24.05.2023; nr. 22, nr. 23 datë 18.01.2023 dhe nr. 73, 74, 75, 76, 77, 78, 79, 80, 81, 82, 83, 84,85 dhe 86 datë 20.02.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Ilir Rusi: Vazhdojmë me një pikë tjetër të këtij rendi dite, që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimeve të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës e cila është renditur në disa nënpika. Për më tej fjalën z. Kurushi me qëllim që të prezantojë relacionet përkatëse sipas objektit të tyre.

Klodian Kurushi: Faleminderit zoti Rusi!

Komisioni ka sjellë disa projektvendime që bëjnë fjalë për ndryshimin e vendimeve që ne si Komision, ne si Këshill kemi marrë më përpara për caktimin e relatorëve në procesin e procedurave të ngritjes në detyrë në disa gjykata dhe të lëvizjes paralele në disa gjykata të tjera.

Projektvendimet e radhës janë gjithsej 8 të tilla, vijnë si rezultat i ndryshimit të relatorëve për shkak të zëvendësimit të anëtarëve të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës dhe përfshirjes në këtë komision edhe të anëtarit të ri, z. Albens Tabaku.

Unë shkurtimisht po bëj propozimin sepse është procedurë vetëm e zëvendësimit të anëtarëve për të hedhur në short çështjet.

Në parim po e them shkurtimisht, janë disa çështje. I referohen çështjeve të ngritjeve në detyrë në Gjykatën kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar. Ngritjet

në detyrë më vendimet që ne kemi marrë për rastet e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, në apelin administrativ si dhe në disa raste të vendimeve që kemi marrë për procedurën e lëvizjeve paralele në gjykatat e shkallëve të para Tiranë, Durrës, Elbasan, dhe në Gjykatën e Shkallës së Parë Administrative Tiranë. Procedura në këto raste nuk është e gjitha që çështjet të hidhen në short për kategoritë e çështjeve. Për shembull, çështjet ku gjyqtari dhe kolegu ynë z. Markelian Koça ka dhënë dorëheqje për disa procedura që lidhen me procesin e ngritjes në detyrë të kandidatëve që kandidojnë në Gjykatën e Apelit Administrativ, ato çështje do t'i marr unë të gjitha që kanë mbetur nga relatori i mëparshëm z. {...}. Ne kemi menduar të mos përfshihet në këtë procedurë z. Tabaku, për sa kohë z. Tabaku nuk është i pajisur me certifikatën e sigurisë, pasi procedura do vijojë më tej me verifikimin edhe të kriterit të pasurisë dhe të figurës, që kërkon pajisjen me certifikatë.

Në ato raste kur nuk ka papajtueshmëri dhe konflikt interesash z. Koça, çështjet do hidhen në short, për ngritjet në detyrë, midis meje dhe z. Koça.

Ndërsa për çështjet që i referohen lëvizjeve paralele, ku nuk ekziston procedura e verifikimit të pasurisë dhe figurës, do përfshihet zoti Albens Tabaku. Në disa raste çështjet nuk do hidhen në short për efekt të ekuilibrit të ngarkesës që duhet të kenë të gjithë anëtarët e Komisionit.

Me pak fjalë, këto janë situatat.

Unë mund t'i sqaroj vetëm një nga një shkurtimisht telegrafikisht, pa e lexuar të gjithë relacionin.

Për shembull, për të vijuar më konkretisht. Çështja e parë “Për një ndryshim në vendimin nr. 264, datë 24.05.2024”, bëhet fjalë “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kandidatëve për në formimin fillestar për magjistrat, profili gjyqtar, në Shkollën e Magjistraturës, për vitin akademik 2024-2025”, janë në short gjithsej 8 (tetë) kandidatë dhe ne kemi menduar që të përfshihen në këtë short vetëm dy anëtarë, që jam unë dhe z. Koça, sepse do bëhet verifikimi i pasurisë dhe figurës së kandidatëve që janë në Shkollën e Magjistraturës në vitin e parë. Përfshihet nga shorti z. Tabaku.

Vazhdojmë më tej, e dyta “Për një ndryshim në vendimin nr. 266, datë 24.05.2024 “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar për pozicionin

e lirë të shpallur me vendimin nr. 247, datë 02.05.2024 dhe Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile të shpallura me vendimet nr. 244, 245, 246 datë 02.05.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”. Në këtë rast ne i propozojmë Këshillit që edhe këto çështje të hidhen në short. Janë gjithsej 6 (gjashtë) kandidatë (një kandidat është në GJKKO dhe pesë kandidatë të tjerë janë si kandidatë që kandidojnë për Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm). Do ndahet ngarkesa tre nga kandidatët që do bien në short do t’i marr unë, ndërsa tre të tjerët do t’i marrë z. Koça. Pra bëhet fjalë për vendimin nr. 266 dhe 247.

Vazhdojmë më tej. E treta “Për një ndryshim në vendimin nr. 57, datë 07.02.2024 “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile të shpallura me vendimet nr. 239, 240, 241, 242, 243, 244, 245, 246 dhe nr. 247, datë 24.05.2023 dhe Gjykatën Administrative të Apelit për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr. 235, 236, 237 dhe 238 [...]”. Në këtë rast nuk ka short sepse bëhet fjalë për 5 kandidatë dhe këto 5 kandidatë i referohen verifikimit të pasurisë dhe figurës. Z. Koça në këtë rast ka dhënë dorëheqjen, ka papajtueshmëri. Z. Albens Tabaku nuk ka mundësi të përfshihet. Kështu që këto çështje do t’i marrë të gjitha unë.

Vazhdojmë më tej. Çështja e katërt “Për një ndryshim në vendimin nr. 66, datë 09.02.2023 “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në: Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr.499, nr.500, 501, datë 21.11.2022; si edhe në Gjykatat e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale të shpallura me vendimet nr. 502, nr.503, 504 datë 21.11.2022”, edhe në këtë rast nuk ka short. Në këtë rast ne kemi propozuar që këto çështje t’i shkojnë për verifikim z. Koça për efekt të ngarkesës. Janë vetëm dy kandidatë që do t’i bëhet verifikimi i kritereve ligjore të tyre.

Çështja e pestë “Për një ndryshim në vendimin nr. 298, datë 05.06.2024 “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan/Durrës/Tiranë/ dhe Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, të shpallura me vendimet nr. 233, 234, 235, 236, 237, 238, 239, 240, 242, 243, datë 02.05.2024 dhe nr.

25

260, datë 16.05.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”. Edhe në këtë rast ne propozojmë që mos të ketë short. Për efekt të ngarkesës këto çështje t’i shkojnë z. Tabaku. Bëhet fjalë vetëm për një verifikim sepse të gjitha të tjerat kanë përfunduar (vetëm për z. {...}). Sepse ky ka një procedim disiplinor në lidhje me masën e propozuar ose jo, masën disiplinore dhe nuk i bëhet dot vlerësimi për pozicionin që ai ka kandidonte në atë kohë kur janë hapur këto vende. Nëse ju kujtohet ka ardhur procedimi disiplinor tek ne. Është marrë një vendim dhe vendimi, në dijeninë tonë nuk ka marrë ende formë të prerë, pasi do ankimohet nga Inspektori i Lartë. Deri tani nuk ka marrë formë të prerë. Nuk di më tej, por deri më sot nuk ka marrë. Po njëkohësisht ishte edhe kjo pjesa e dytë që bëhej verifikimi i çështjeve nëse ka apo jo çështje në hetim. E kemi më të freskët këtë çështjen prandaj e mora si shembull dhe do presim sa të përfundojë procedura. Jemi brenda afateve. S’ka marrë vendimi ynë formë të prerë, kështu që do presim nëse do bëjë apo nuk do bëjë ankim Inspektori i Lartë ose edhe vetë kandidati (sepse të dy palët kanë të drejtën për të bërë ankim).

Pika 6 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional për gjyqtarët pjesë e programit të vlerësimeve për vitin 2024”, i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale (relatore znj. Irena Plaku).⁶

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:14 dhe mbaroi në orën 15:08.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 3. Irena Plaku | (anëtare) |
| 4. Gentiana Muçaj | (anëtare) |
| 5. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 6. Bledar Bajri | (anëtar) |
| 7. Albens Tabaku | (anëtar) |
| 8. Markelian Koça | (anëtar) |
| 9. Yllka Rupa | (anëtare) |

⁶ Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e pesta sipas rendit të ditës.

Shënim: Nuk morën pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor *znj. Naureda Llagami*, si dhe anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Emona Muçi*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**
- 2. Luan Dibra, Gentiana Agushi, Maela Alicanaj, Rezarta Taushani, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**
- 3. Denisa Varfi dhe Entela Dobi përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.**
- 4. Petrika Thano, MCA-PRESS.**
- 5. Sidorela Driçi, AIS Instituti Shqiptar i Shkencës, Open Data.**
- 6. Staf nga administrata e KLGJ-së.**

RENDI I DITËS:

6. Shqyrtimi i projektvendimit “Për fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional për gjyqtarët pjesë e programit të vlerësimeve për vitin 2024”, i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale (relatore *znj. Irena Plaku*).

Ilir Rusi: Vazhdojmë me një pikë tjetër të rendit të ditës që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional për gjyqtarët pjesë e programit të vlerësimeve për vitin 2024”, për të cilën është përgatitur relacioni nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale. Me relatore *znj. Plaku* (për të cilën ka short).

Irena Plaku: Faleminderit!

Këshilli i Lartë Gjyqësor me vendimin nr.18, datë 18.01.2024 ka miratuar “Programin e vlerësimit etik dhe profesional për vitin 2024”, duke përfshirë në program 35 gjyqtarë, si dhe duke përcaktuar prioritetet e planifikimeve 3-mujore.

Në vijim të zbatimit të këtij projekt programi, bazuar në parashikimet e nenit 85 të ligjit nr.96/2016, të ndryshuar, si dhe vendimit nr.18, datë 18.01.2024, si dhe duke marrë në konsideratë situatën faktike në të cilën janë të angazhuar anëtarët e KVEVP, me vlerësimet e përshpejtuara të detyruara, gradimet e gjyqtarëve të konfirmuar me vendim të formës së prerë nga organet e rivlerësimit dhe vlerësimet 3-vjeçare për periudhën e vlerësimit 2017-2019 dhe 2020-2022, programi i vlerësimeve për vitin 2024 është vlerësuar që të zhvillohet në 2 faza.

Konkretisht, me vendimin nr. 226, datë 25.04.2024 të KLGJ ka filluar procedura e vlerësimit etik dhe profesional për 14 (katërmëdhjetë) gjyqtarë, nga të cilët 5 (pesë) për periudhën 2020-2022 dhe 9 (nëntë) për periudhën 2021-2023, pjesë e programit të vlerësimit 2024, kjo duke marrë në konsideratë rendin e përparësive të përcaktuar në pikën 4 të vendimit nr. 645, datë 23.12.2021, ndërsa për 21 (njëzet e një) gjyqtarët e tjerë, pjesë e programit të vlerësimit 2024, procedurat e vlerësimit janë vlerësuar të zhvillohen në 4-mujorin e dytë.

Para përcaktimit të gjyqtarëve që do të përfshihen në fazën e dytë të fillimit të procesit të vlerësimit etik dhe profesional, Komisioni konstatoi se nga 21 (njëzet e një) gjyqtarët e mbetur pjesë e programit të vlerësimit, nuk mund të fillojnë procedurën e vlerësimit etik dhe profesional për 1 (një) prej tyre, për shkak se gjyqtari aktualisht nuk ushtrojnë funksionin e gjyqtarit për shkak të pezullimit nga detyra, me vendimin nr. 61, datë 07.02.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Ky vlerësim vlerësohet të fillojë menjëherë pas rënies së shkakut të pezullimit.

Sa më sipër, Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, në zbatim të nenit 85 dhe 97 të Ligjit për Statusin, vendimit me nr. 263, datë 21.11.2019 “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve” dhe vendimit nr.18, datë 18.01.2024, me qëllim realizimin e programit të miratuar të vlerësimit etike dhe profesionale për vitin 2024, i propozon mbledhjes plenare, fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional për periudhën e vlerësimit 2017-2019 për 1 (një) gjyqtar, i cili ka ushtruar detyrën në periudhën e vlerësimit 2017-2019, fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional për periudhën e vlerësimit 2020-2022 për 10 (dhjetë) gjyqtarë, të cilët kanë ushtruar detyrën në këtë periudhë vlerësimi dhe fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional për periudhën 2021-2023 për 7 (shtatë)

gjqtarë, të cilët kanë ushtruar detyrën në periudhën e vlerësimit 2021-2023, në gjykatat e mëposhtme, konkretisht:

Për periudhën 2017-2019 – {...}.

Për periudhën e vlerësimit 2020-2022 është z. {...}, znj. {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}.

Për periudhën 2021-2023 është {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...} dhe {...}.

Procesi i vlerësimit etik dhe profesional për periudhën 2017-2019, 2020-2022 dhe 2021-2023 do të zhvillohet në bazë të burimeve të vlerësimit të përcaktuara në nenin 77 të Ligjit për Statusin, rregullave të përcaktuara në nenet 71 e vijues të këtij ligji dhe vendimeve nr.263, datë 21.11.2019 “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve” dhe nr.264, datë 21.11.2019 [...].

Në zbatim të nenit 89 të Ligjit për Statusin dhe nenit 12 të Vendimit nr.263/2019, duke marrë në konsideratë ngarkesën aktuale të punës të anëtarëve të komisionit, si dhe duke mbajtur parasysh, për aq sa është e mundur, barazinë e shpërndarjes së punës mes anëtarëve të KVEVP-së, i propozon mbledhjes, që në procedurat e caktimit të relatorit të përfshihen të 3 (tre) anëtarët e Komisionit, me një shpërndarje ngarkese të barabartë, me nga 6 (gjashtë) vlerësime secili (sepse janë 18 vlerësime), duke i ndarë 6 anëtarë për zonjën Plaku, 6 për znj. Muçaj dhe 6 për z. Rusi. Gjithashtu në procedurat e shortit përfshihen edhe tre nëpunëse përgjegjëse të vlerësimit, znj. Agaj, znj. Merita Karaj dhe znj. {...}, me një shpërndarje të ndryshme si më poshtë: 3 për nëpunësen përgjegjëse znj. Erlanda Agaj, 4 për nëpunësen përgjegjëse znj. Merita Karaj dhe 11 për nëpunësen përgjegjëse znj. {...} (pasur parasysh edhe ngarkesën e tyre).

Në pikat 1, 2, dhe 3 të projektvendimit përcaktohet fillimi i procedurës së vlerësimit etik dhe profesional për periudhën e vlerësimit 2017-2019 për 1 gjyqtar, 2020-2022 për 10 gjyqtarë dhe për periudhën e vlerësimit 2021-2023 për 7 gjyqtarë, të cilët janë pjesë e programit të vlerësimeve për vitin 2024.

Në pikën 2, 4 dhe 6 të projektvendimit, përcaktohet caktimi i relatorit dhe nëpunësit përgjegjës për vlerësim për gjyqtarët subjekt vlerësimi, proces i cili realizohet nëpërmjet shortit midis anëtarëve të përhershëm të Komisionit dhe anëtarëve të Komisionit domethënë.

Së fundi, në projektvendim përcaktohet dhe hyrja në fuqi e këtij vendimi, konkretisht menjëherë me botimin në faqen zyrtare të internetit.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit!

Ka diskutime për sa u parashtrua?

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, ftoj administratën për të përgatitur dhe hedhur shortin sipas asaj çfarë u relatua.

Procedura e hedhjes së shortit si vijon:

Në enën e parë të qelqit vendosen shiritat me emrat e gjyqtarëve: z. {...}, z. {...}, znj. {...}, znj. {...}, znj. {...}, z. {...}, znj. {...}, z. {...}, znj. {...}, z. {...}, z. {...}, z. {...}, znj. {...}, znj. {...}, z. {...}, znj. {...}, znj. {...}, znj. {...}.

Në enën e dytë të qelqit vendosen shiritat me emrat e relatorëve: znj. Irena Plaku (6 shirita me emrin e znj. Plaku), z. Ilir Rusi (6 shirita me emrin e z. Rusi), znj. Gentiana Muçaj (6 shirita me emrin e znj. Muçaj).

Në enën e tretë të qelqit vendosen shiritat me emrat e nëpunësve përgjegjës: znj. Erlanda Agaj (3 shirita me emrin e znj. Agaj), znj. Merita Karaj (4 shirita me emrin e znj. Karaj) dhe znj. {...} (11 shirita me emrin e znj. Gjoni).

Procedura e përzgjedhjes së goglave si vijon:

Përzgjidhet gogla e parë nga gjyqtarët. I përzgjedhur nga gogla e parë rezulton z. {...} (periudha 2017-2019). Për zotin {...}, përzgjidhet relatori që rezulton znj. Irena Plaku dhe nëpunës përgjegjës përzgjidhet znj. {...}.

Përzgjidhet gogla e dytë nga gjyqtarët. I përzgjedhur nga gogla e dytë rezulton z. {...} (periudha 2020-2022). Për zotin {...}, përzgjidhet relatori që rezulton z. Ilir Rusi dhe nëpunës përgjegjës përzgjidhet znj. {...}.

Përzgjidhet gogla e tretë nga gjyqtarët. I përzgjedhur nga gogla e tretë rezulton z. {...} (periudha 2020-2022). Për zotin {...}, përzgjidhet relatori që rezulton znj. Gentiana Muçaj dhe nëpunës përgjegjës përzgjidhet znj. {...}.

Përzgjidhet gogla e katërt nga gjyqtarët. E përzgjedhur nga gogla e katërt rezulton znj. {...} (periudha 2020-2022). Për zonjën {...}, përzgjidhet relatori që rezulton znj. Gentiana Muçaj dhe nëpunës përgjegjës përzgjidhet znj. Merita Karaj.

Përzgjidhet gogla e pestë nga gjyqtarët. E përzgjedhur nga gogla e pestë rezulton znj. {...} (periudha 2021-2023). Për zonjën {...}, përzgjidhet relatori që rezulton z. Ilir Rusi dhe nëpunës përgjegjës përzgjidhet znj. {...}.

Përzgjidhet gogla e gjashtë nga gjyqtarët. I përzgjedhur nga gogla e gjashtë rezulton z. {...} (periudha 2020-2022). Për zotën {...}, përzgjidhet relatori që rezulton znj. Gentiana Muçaj dhe nëpunës përgjegjës përzgjidhet znj. Merita Karaj.

Përzgjidhet gogla e shtatë nga gjyqtarët. E përzgjedhur nga gogla e shtatë rezulton znj. {...} (periudha 2020-2022). Për zonjën {...}, përzgjidhet relatori që rezulton znj. Irena Plaku dhe nëpunës përgjegjës përzgjidhet znj. Erlanda Agaj.

Përzgjidhet gogla e tetë nga gjyqtarët. I përzgjedhur nga gogla e tetë rezulton z. {...} (periudha 2020-2022). Për zotën {...}, përzgjidhet relatori që rezulton z. Ilir Rusi dhe nëpunës përgjegjës përzgjidhet znj. {...}.

Përzgjidhet gogla e nëntë nga gjyqtarët. E përzgjedhur nga gogla e nëntë rezulton znj. Erlanda Agaj (periudha 2020-2022). Për zonjën {...}, përzgjidhet relatori që rezulton znj. Gentiana Muçaj dhe nëpunës përgjegjës përzgjidhet znj. {...}.

Përzgjidhet gogla e dhjetë nga gjyqtarët. E përzgjedhur nga gogla e dhjetë rezulton znj. {...} (periudha 2021-2023). Për zonjën {...}, përzgjidhet relatori që rezulton znj. Irena Plaku dhe nëpunës përgjegjës përzgjidhet znj. {...}.

Përzgjidhet gogla e njëmbëdhjetë nga gjyqtarët. I përzgjedhur nga gogla e njëmbëdhjetë rezulton z. {...} (periudha 2020-2022). Për zotën {...}, përzgjidhet relatori që rezulton znj. Irena Plaku dhe nëpunës përgjegjës përzgjidhet znj. {...}.

Përzgjidhet gogla e dymbëdhjetë nga gjyqtarët. I përzgjedhur nga gogla e dymbëdhjetë rezulton z. {...} (periudha 2021-2023). Për zotën {...}, përzgjidhet relatori që rezulton z. Ilir Rusi dhe nëpunës përgjegjës përzgjidhet znj. Erlanda Agaj.

Përzgjidhet gogla e trembëdhjetë nga gjyqtarët. E përzgjedhur nga gogla e trembëdhjetë rezulton znj. {...} (periudha 2021-2023). Për zonjën Buzo, përzgjidhet relatori që rezulton znj. Irena Plaku dhe nëpunës përgjegjës përzgjidhet znj. Erlanda Agaj.

Përzgjidhet gogla e katërbëdhjetë nga gjyqtarët. E përzgjedhur nga gogla e katërbëdhjetë rezulton znj. {...} (periudha 2021-2023). Për zonjën {...}, përzgjidhet relatori që rezulton znj. Irena Plaku dhe nëpunës përgjegjës përzgjidhet znj. {...}. *(Shorti për përzgjedhjen e nëpunëses u ripërsërit në kushtet kur zonja Gjoni nuk mund të hartojë raportin e saj vlerësues. Rifutet në enën e qelqit gogla me emrin e znj. Gjoni. Në procedurën e dytë të përzgjedhjes së nëpunësit u përzgjedh sërish zonja Gjoni. U ripërsërit shorti duke u rifutur gogla me emrin e zonjës Gjoni në enën e qelqit).* Në procedurën e tretë të përzgjedhjes së nëpunësit përgjegjës shorti i ra znj. Merita Karaj. Pra nëpunës përgjegjës për zonjën {...} përzgjidhet znj. Merita Karaj.

Përzgjidhet gogla e pesëmbëdhjetë nga gjyqtarët. E përzgjedhur nga gogla e pesëmbëdhjetë rezulton znj. {...} (periudha 2020-2022). Për zonjën {...}, përzgjidhet relatori që rezulton z. Ilir Rusi dhe nëpunës përgjegjës përzgjidhet znj. {...}.

Përzgjidhet gogla e gjashtëmbëdhjetë nga gjyqtarët. E përzgjedhur nga gogla e gjashtëmbëdhjetë rezulton znj. {...} (periudha 2020-2022). Për zonjën {...}, përzgjidhet relatori që rezulton z. Ilir Rusi dhe nëpunës përgjegjës përzgjidhet znj. {...}.

Përzgjidhet gogla e shtatëmbëdhjetë nga gjyqtarët. E përzgjedhur nga gogla e shtatëmbëdhjetë rezulton znj. {...} (periudha 2021-2023). Për zonjën {...}, përzgjidhet relatori që rezulton znj. Gentiana Muçaj dhe nëpunës përgjegjës përzgjidhet znj. {...}.

Përzgjidhet gogla e tetëmbëdhjetë nga gjyqtarët. I përzgjedhur nga gogla e tetëmbëdhjetë rezulton z. {...} (periudha 2021-2023). Për zotën {...}, përzgjidhet relatori që rezulton znj. Gentiana Muçaj dhe nëpunës përgjegjës përzgjidhet znj. Merita Karaj.

Ilir Rusi: Keni diskutime mbi hedhjen e shortit dhe rezultatet e tij?

(Nuk ka diskutime.)

Atëherë kalojmë në votimin e projektvendimit përkatës të përditësuar sipas të dhënave që rezultuan nga shorti i sapo hedhur.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Bledar Bajri: Dakord.

Albens Tabaku: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional për gjyqtarët pjesë e programit të vlerësimeve për vitin 2024”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, relacionin dhe përditësimet e bëra nga shorti i sapo hedhur mori vendimin përkatës.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me botimin në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 6 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 24.09.2024)

Pika 7 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional për gjyqtaret {...} dhe {...}, pjesë e programit të vlerësimeve për vitin 2024”, i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale.⁷

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:14 dhe mbaroi në orën 15:08.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 3. Gentiana Muçaj | (anëtare) |
| 4. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 5. Bledar Bajri | (anëtar) |
| 6. Albens Tabaku | (anëtar) |
| 7. Markelian Koça | (anëtar) |
| 8. Yllka Rupa | (anëtare) |

⁷ Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e gjashta sipas rendit të ditës.

Shënim: Nuk morën pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor *znj. Naureda Llagami*, si dhe anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Emona Muçi*.

Shënim: Nuk mori pjesë në shqyrtimin e kësaj pike *znj. Irena Plaku*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

2. Luan Dibra, Gentiana Agushi, Maela Alicanaj, Rezarta Taushani, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.

3. Denisa Varfi dhe Entela Dobi përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.

4. Petrika Thano, MCA-PRESS.

5. Sidorela Driçi, AIS Instituti Shqiptar i Shkencës, Open Data.

6. Staf nga administrata e KLGJ-së.

RENDI I DITËS:

7. Shqyrtimi i projektvendimit “Për fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional për gjyqtaret {...} dhe {...}, pjesë e programit të vlerësimeve për vitin 2024”, i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale.

Ilir Rusi: Në vijim vazhdojmë me një pikë tjetër të rendit të ditës që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional për gjyqtaret {...} dhe {...}, pjesë e programit të vlerësimeve për vitin 2024”, për të cilën është përgatitur relacioni nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale. Relatore do të jetë *znj. Gentiana Muçaj*. Në shqyrtimin e kësaj pike nuk merr pjesë *znj. Plaku*.

Gentiana Muçaj: Këshilli i Lartë Gjyqësor me vendimin nr.18, datë 18.01.2024 ka miratuar “Programin e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve për vitin 2024”, duke përfshirë në program 35 gjyqtarë, si dhe duke përcaktuar prioritetet e planifikimeve 3-mujore.

Në vijim të zbatimit të këtij programi, bazuar në parashikimet e nenit 85 të ligjit nr.96/2016, pikën IV të vendimit nr.18, datë 18.01.2024, si dhe duke marrë në konsideratë situatën faktike në të cilën janë të angazhuar anëtarët e KVEVP, me vlerësimet e përshpejtuara të detyruara, gradimet e gjyqtarëve të konfirmuar me vendim të formës së prerë nga organet e rivlerësimit dhe vlerësimet 3-vjeçare për periudhën e vlerësimit 2017-2019 dhe 2020-2022, programi i vlerësimeve për vitin 2024 është vlerësuar që të zhvillohet në 2 faza.

Me vendimin nr. 226, datë 25.04.2024 të KLGJ ka filluar procedura e vlerësimit etik dhe profesional për 14 (katërmëdhjetë) gjyqtarë, nga të cilët 5 (pesë) për periudhën e vlerësimit 2020-2022 dhe 9 (nëntë) për periudhën 2021-2023, pjesë e programit të vlerësimit 2024, kjo duke marrë në konsideratë rendin e përparësive të përcaktuar në pikën 4 të vendimit nr. 645, datë 23.12.2021, ndërsa për 21 (njëzet e një) gjyqtarët e tjerë, pjesë e programit të vlerësimit 2024, procedurat e vlerësimit janë vlerësuar të zhvillohen në 4-mujorin e dytë të vitit 2024.

Sa më sipër, Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, me qëllim realizimin e programit të miratuar të vlerësimeve etike dhe profesionale për vitin 2024, i propozon mbledhjes plenare, fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional për periudhën e vlerësimit 2017-2019 për gjyqtaren {...} dhe për periudhën 2020-2022 për gjyqtaren {...}, të cilat kanë ushtruar detyrën e gjyqtarës në periudhën e vlerësimit, në Gjykatat Administrative të Shkallës së Parë Vlorë dhe Gjirokastrë, aktualisht Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Lushnje.

Procesi i vlerësimit etik dhe profesional për periudhën e vlerësimit 2017-2019 dhe 2020-2022 do të zhvillohet mbi bazën e burimeve të vlerësimit të përcaktuara në nenin 77 të Ligjit për Statusin, rregullave të përcaktuara në nenet 71 e vijues të këtij ligji dhe vendimeve të KLGJ-së.

Në zbatim të nenit 89 të Ligjit për Statusin dhe nenit 12 të vendimit të Këshillit nr.263/2019, duke marrë në konsideratë ngarkesën aktuale të punës të anëtarëve të komisionit, si dhe duke mbajtur parasysh, për aq sa është e mundur, barazinë e shpërndarjes së punës mes anëtarëve, Komisioni i propozon mbledhjes plenare, që në procedurat e caktimit të relatorit të përfshihen dy anëtarët e përhershëm të Komisionit të Vlerësimit Etik dhe Profesional znj. Gentiana Muçaj dhe znj. Ilir Rusi, si dhe anëtari

gjqtar zëvendësues z.Ridvan Hado, sipas vendimit nr.486, datë 13.09.2024. Po kështu, procedura e shortit do të zhvillohet në barazinë e shpërndarjes së ngarkesës së punës midis 3 (tre) nëpunësve të vlerësimit, znj. Erlanda Agaj, znj. Merita Karaj dhe znj. Entela Gjoni.

Kështu që projektvendimi përmban këto pika:

Në pikat 1 dhe 3 të projektvendimit përcaktohet fillimi i procedurës së vlerësimit etik dhe profesional për periudhën e vlerësimit 2017-2019 për gjyqtaren {...} dhe për periudhën e vlerësimit 2020-2022 për gjyqtaren {...}, të cilat janë pjesë e programit të vlerësimeve për vitin 2024.

Në pikën 2 dhe 4 të projektvendimit përcaktohet caktimi i relatorit dhe nëpunësit përgjegjës për vlerësimin për gjyqtarët subjekt vlerësimi, proces i cili realizohet nëpërmjet shortit midis dy anëtarëve të përhershëm dhe anëtarit gjyqtar zëvendësues të Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale për relatorin dhe ndërmjet tre nëpunësve të Njesisë së Vlerësimit Etik dhe Profesional, sipas nenit 12 pika 2 të vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 263, datë 21.11.2019.

Së fundi, në projektvendim përcaktohet dhe hyrja në fuqi e tij, konkretisht menjëherë me botimin në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit!

Ka diskutime për sa u parashtrua?

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, ftoj administratën për të hedhur shortin.

Procedura e hedhjes së shortit si vijon:

Në enën e parë të qelqit vendosen shiritat me emrat e gjyqtarëve: znj. {...} dhe znj. {...}.

Në enën e dytë të qelqit vendosen shiritat me emrat e relatorëve: z. Ilir Rusi, znj. Gentiana Muçaj, z. Ridvan Hado.

Në enën e tretë të qelqit vendosen shiritat me emrat e nëpunësve përgjegjës: znj. Erlanda Agaj, znj. Merita Karaj dhe znj. Entela Gjoni.

Procedura e përzgjedhjes së goglave si vijon:

Përzgjidhet gogla e parë nga gjyqtarët. E përzgjedhur nga gogla e parë rezulton znj. {...} (periudha 2020-2022). Për zonjën {...}, përzgjidhet relatori që rezulton znj. Gentiana Muçaj dhe nëpunës përgjegjës përzgjidhet znj. Erlanda Agaj.

Përzgjidhet gogla e dytë nga gjyqtarët. E përzgjedhur nga gogla e dytë rezulton znj. {...} (periudha 2017-2019). Për zonjën {...}, përzgjidhet relatori që rezulton z. Ilir Rusi dhe nëpunës përgjegjës përzgjidhet znj. Merita Karaj.

Ilir Rusi: Faleminderit!

Ka diskutime mbi hedhjen e shortit?

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë tek votimi i projektvendimit të përditësuar me të dhënat e shortit.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Bledar Bajri: Dakord.

Albens Tabaku: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional për gjyqtaret {...} dhe {...}, pjesë e programit të vlerësimeve për vitin 2024”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi sipas relacionit dhe përditësimit të bërë nga shorti i sapo hedhur.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me botimin në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 7 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 24.09.2024)

Pika 8 shtesë e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit në procedurat e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, shpallur me vendimet nr. 489, 490, 491, 492, 493, datë 13.09.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).⁸

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:14 dhe mbaroi në orën 15:08.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 3. Irena Plaku | (anëtare) |
| 4. Gentiana Muçaj | (anëtare) |
| 5. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 6. Bledar Bajri | (anëtar) |
| 7. Albens Tabaku | (anëtar) |

⁸ Kjo çështje u shtua në rendin e ditës. Shih procesverbalin e pikes 4 ku edhe u miratua si pikë shtesë. 67

8. *Markelian Koça* (anëtar)
9. *Yllka Rupa* (anëtare)

Shënim: Nuk morën pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor *znj. Naureda Llagami*, si dhe anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Emona Muçi*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Blerita Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
2. *Luan Dibra, Gentiana Agushi, Maela Alicanaj, Rezarta Taushani, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
3. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.*
4. *Petrika Thano, MCA-PRESS.*
5. *Sidorela Driçi, AIS Instituti Shqiptar i Shkencës, Open Data.*
6. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

8 shtesë. Shqyrtimi i projektvendimit “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit në procedurat e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, shpallur me vendimet nr. 489, 490, 491, 492, 493, datë 13.09.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Ilir Rusi: Në vijim, për shkak edhe të natyrës së këtij që do të ketë short, dhe për të përfunduar ato çështje të cilat duhet hedhur shorti, do vazhdojmë me atë pikë të cilën shtuam përgjatë kësaj mbledhjeje, që ka të bëjë me “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit në procedurat e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, shpallur me vendimet nr. 489, 490, 491, 492, 493, datë 13.09.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”. Për më tej fjalën relatorit, z. Kurushi.

Klodian Kurushi: Faleminderit zoti Rusi!

Në mbledhjen plenare të datës 13.09.2024, në ushtrim të funksionit kushtetues dhe ligjor për të siguruar mbarëvajtjen dhe administrimin e pushtetit gjyqësor, por edhe përgjegjësisë për të siguruar pavarësinë dhe përgjegjshmërinë e këtij institucioni, me vendimet nr. 489, 490, 491, 492 dhe 493 datë 13.09.2024 Këshilli i Lartë Gjyqësor hapi procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Shkallës së parë të Juridiksionit të përgjithshëm Tiranë (5 pozicione).

Për procesin e lëvizjes paralele, si një nga format e transferimit të magjistratit, janë parashikuar rregulla që adresojnë si nevojat e sistemit të drejtësisë, ashtu edhe të drejtën e magjistratit për të zhvilluar karrierën e tij.

Afati i kandidimit për këto procedura të lëvizjes paralele u përcaktua deri më datë 20.09.2023.

Brenda afatit të kandidimit u paraqitën gjithsej 26 (njëzet e gjashtë) kandidatura, të cilët kanë aplikuar në procedurat e lëvizjes paralele për pozicionet e lira fushën civile e penale në pozicionet e prezantuara si më lart.

Kemi bërë edhe publikimin e emrave të kandidatëve në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Njëkohësisht e kemi bërë këtë njoftim edhe për të gjithë anëtarët se cilët janë kandidatët që kanë kandiduar në pozicionet përkatëse të shpallura me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Lidhur me verifikimin, pra vijon procedura për verifikimin e kriterëve ligjore të kandidimit në procedurat e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë për vendimet e shpallura në 5 pozicionet, fillimisht 489 – 193, datë 13.09.2024.

Lidhur me verifikimin e kandidatëve që kandidojnë për procedurat e lëvizjeve paralele Këshilli ka miratuar në mënyrë të detajuara rregullat përmes vendimit të tij nr. 320, datë 17.09.2020.

Në respektim të këtyre rregullave, Këshilli duhet të disponojë për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Në kreun katër të vendimeve respektive nr. 489 - nr. 493/2024, Këshilli përcaktoi edhe procedurën përkatëse që do të ndiqet si më poshtë:

IV. Procedura e lëvizjes paralele

8. Procedura e lëvizjes paralele zhvillohet në tre faza, si më poshtë:

a) në fazën e parë bëhet verifikimi i kandidatëve për plotësimin e kritereve ligjore të kandidimit; - pra është ky propozim për vendimmarrje që të fillojnë procedurat e verifikimit të kandidatëve për plotësimin apo jo prej tyre të kritereve ligjore.

b) në fazën e dytë bëhet renditja e kandidatëve;

c) në fazën e tretë merret vendimi për transferimin e kandidatit të renditur më lart në renditje.

9. Pas përfundimit të afatit të kandidimit sipas pikës 3 të këtij vendimi, mbi propozimin e Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, Këshilli miraton me vendim listën e kandidatëve që kanë ose që mund të kenë dy vlerësime, të atyre që kanë ose që mund të kenë një vlerësim, si dhe të kandidatëve që nuk kanë dhe që nuk mund t'u bëhet asnjë vlerësim.

10. Pas vendimit të Këshillit sipas pikës 9, fillon faza e parë e procedurës së lëvizjes paralele, ku kandidatët që kanë ose që mund të kenë dy vlerësime, i nënshtrohen fillimisht procesit të verifikimit të plotësimin të kritereve ligjore të kandidimit sipas shkronjave "a", "b" dhe "c", të pikës 5, të këtij vendimi, proces ky që realizohet sipas kërkesave të vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 320/2020.

Këshilli me vendimin e sotëm datë 24.09.2024 ndër të tjera vendosi miratimin e listës së gjyqtarëve që kanë ose mund të kenë dy vlerësime për efekt të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, të shpallur me vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr.489, nr.490, nr.491 nr.492 dhe nr.493, datë 13.09.2024, sipas Shtojcës I bashkëngjitur këtij vendimi.

Shtojca e parë është lista e gjyqtarëve që kanë 2 (dy) vlerësime: është z. {...}, gjyqtar i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër; (e miratuam ditën e sotme, që ka dy vlerësime); z. {...}, gjyqtar i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë i cili është caktuar përkohësisht në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë; (ka kandiduar edhe në

procedurat e fundit të hapura me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor). Pra për një nga këto pesë vende që kemi hapur.

Lista e gjyqtarëve që mund të kenë 2 (dy) vlerësime: është z. {...}; është znj. {...}; është z. {...}.

Në këto kushte, në përputhje me pikën 9 të vendimeve, të mësipërme (5 vendime të vitit 2024), si dhe në mbështetje të vendimit nr. 320, datë 17.09.2020, “Për kriteret dhe procedurat e lëvizjes paralele të gjyqtarëve”, Komisioni i propozon Këshillit të miratojë projektvendimin për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, të shpallura me vendimet e cituara më lart (pra janë 5 vendimet e mësipërme).

Këta kandidatë sipas shtojcës janë:

Zoti {...} i cili ka kandiduar edhe më parë për lëvizjen paralele në pozicionet nr. 80 dhe nr. 81 të vitit 2024; si edhe për pozicionin nr.502/2022 për ngritje në detyrë. Pra, që t’ia shpjegoj Këshillit.

Zoti {...} aktualisht ka tre kandidime në proces, ka një të vitit 2022 për ngritjen në detyrë dhe është pozicioni 502 për t’u ngritur në detyrë në Gjykatën e Apelit, njëkohësisht ka edhe dy kërkesa të tjera për lëvizje paralele që respektohen me pozicionet 80 dhe 81 të vitit 2024.

Tani, përveç këtyre tre kërkesave, ka bërë edhe kërkesën e katërt, dhe duhet ta sqaroj pse përfshihet. Duhet ta sqaroj këtë pjesën (siç mendojmë neve).

Për gjyqtarin {...}, gjyqtar i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, i emëruar si gjyqtar në vitin 1993, gradimi nuk mund të realizohet, pasi këtij gjyqtari me vendimin e ndërmjetëm nr.5, datë 24.07.2020 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit i është dhënë masa disiplinore e pezullimit nga detyra për një periudhë 1-vjeçare me detyrimin për të ndjekur programin e trajnimit, sipas kurikulave të miratuara nga Shkolla e Magjistraturës. Ky vendim i paankimueshëm e bën të pamundur realizimin e procesit të vlerësimit me qëllim gradimi për gjyqtarin, i cili për periudhën e vlerësimit 2013-2016, nga organi kushtetues që e ka këtë kompetencë, është vlerësuar se nuk ka arritur nivelin minimal profesional, mbi të cilin Këshilli mund të përcaktojë gradën (nivelin) e vlerësimit. Ky vlerësim që është bërë nga KPK-ja, për efekt të

niveleve të vlerësimit të përcaktuar në nenin 78 pika 1 të Ligjit “Për Statusin” barazohet me atë “të pamjaftueshëm”. Për këto arsye më herët Këshilli, pra ne kemi vendosur përfundimin e procedurës së vlerësimit pa vendim përfundimtar. Nga ana tjetër, vlerësimi i fundit etik-profesional që ky gjyqtar ka qenë ai përpara hyrjes në fuqi të Ligjit “Për Statusin”, i cili është miratuar me vendimin nr. {...} datë 13.11.2015 të ish-KLD-së për periudhën e vlerësimit 2007-2009 në nivelin “shumë mirë”. Për këtë gjyqtar organet e rivlerësimit kalimtar e kanë shtrirë periudhën e rivlerësimit të aftësive profesionale nga data 01.01.2006 deri në tetor të vitit 2016, duke u vlerësuar se nuk arrin nivelin minimal profesional. Në vijim ky gjyqtar ka ndjekur vitin akademik pranë Shkollës së Magjistraturës për periudhën 2020-2021, sipas kurikulave të miratuara për programin teorik dhe praktik, në përfundim të së cilit është vlerësuar në nivelin “Mirë” (është vlerësuar nga Shkolla e Magjistraturës në nivelin “Mirë”) duke i kaluar mangësitë e parashtruara nga KPK-ja. Vlerësimi përfundimtar në nivelin “Mirë” është miratuar nga Këshilli Drejtues i Shkollës së Magjistraturës, me vendimin Nr. {...} datë 15.07.2021. Ky vlerësim i është përcjellë Sekretarit të Përgjithshëm të Komisionit e vëzhguesve ndërkombëtarë dhe është rimarrë në shqyrtim nga KPK, i cili me vendimin Nr. {...} datë 16.09.2021 ka konfirmuar në detyrë gjyqtarin, ku për kriterin e aftësisë profesionale ka pranuar vlerësimin e bërë nga Shkolla e Magjistraturës (pra në shtator të vitit 2021). Në këto kushte ky nivel vlerësimi “Mirë” i miratuar nga organi kompetent, Këshilli Drejtues i Shkollës së Magjistraturës, përbën vlerësimin e fundit të mundshëm në kohë të realizuar për gjyqtarin {...}, për të cilin Këshilli nuk mund të fillojë një vlerësim tjetër (pra është bërë vlerësimi në 2021 dhe ndaj tij nuk mund të fillonte një vlerësim tjetër pa kaluar afati i radhës – do dhe plotësimin e kohës për të bërë vlerësimin e dytë se vlerësimi i parë është bërë në vitin 2021), pra nuk mund të fillojë vlerësimi tjetër qoftë për periudhën para vitit 2020, në kushtet kur Shkolla e Magjistraturës ka vlerësuar aftësinë profesionale dhe menaxheriale të gjyqtarit deri në vitin 2021, as për periudhën e mëpasshme, sepse nuk plotësohen kushtet për fillimin e një vlerësimi të përsheptuar të detyruar për vitin 2022, pasi nuk kanë kaluar 2 vite nga vlerësimi i fundit. Bëhet fjalë për vitin 2022 kur janë hapur vendet (pra që do t’i referohemi vlerësimeve më përpara sesa viti 2022, janë hapur vendet në nëntor të vitit 2022).

Në përfundim të këtij argumentimi z. {...} nuk është i përfshirë në listën e gjyqtarëve të cilëve u ka filluar vlerësimi i përshpejtuar për vitin 2022. Ne kemi marrë një vendim nr. 325, datë 14.06.2023 ku ka përfshirë në listën e gjyqtarëve që mund t'u bëhet vlerësimi i dytë i përshpejtuar pasi kishin bërë vlerësimin e parë, atë që ishte i gradimit dhe në këtë vendim që kemi marrë nuk e kemi përfshirë zotin {...} sepse nuk mund të realizohej vlerësimi i përshpejtuar i dytë për ngritje në detyrë. Gjithmonë flasim për ngritje në detyrë, jo për lëvizjen paralele. Kështu që, ai pavarësisht se ka akoma ngritjen në detyrë si kërkesë, ne jemi shprehur me vendim në datë 14.06.2023 që atij nuk mund t'i bëhet vlerësimi i dytë i ngritjes në detyrë. Pra s'mund të ketë dy vlerësime dhe si i tillë nuk mund të vijojë më tej procedurat për ngritjen në detyrë. Megjithëse nuk ka hequr dorë nga kjo procedurë. Por ne si Këshill jemi shprehur, që nuk mund të ketë një vlerësim të dytë. Kështu që, realisht në garë z. {...} i mbesin përveçse dy kërkesat që ai ka bërë për lëvizjes paralele në pozicionet e mëparshme (pra në pozicionet 80 dhe 81), i mbetet edhe kërkesa e tretë që e ka bërë aktualisht për pozicionin në fushën e së drejtës penale. Pra ai realisht ka katër kërkesa por...

Albens Tabaku (pa mikrofon ndezur): Quhet e rrëzuar ajo kërkesa për ngritjen në detyrë apo quhet e pashqyrtueshme?

Klodian Kurushi: Ka filluar verifikimi fillimisht i kritereve ligjore për ngritjen në detyrë për z. {...}, por është marrë një vendim. Kur është marrë vendimi i Këshillit për të përfshirë në vlerësimin e përshpejtuar të gjyqtarëve që kanë bërë kërkesa për t'u ngritur në detyrë për vitin 2022, për zotin {...} ne kemi marrë një vendim dhe kemi thënë: "...nuk përfshihet në listë sepse nuk mund t'i bëhet vlerësimi i dytë i tij". Nuk mund t'i bëhet vlerësimi i dytë i përshpejtuar.

Irena Plaku (pa mikrofon ndezur): Ai ka kandiduar në një pozicion që të gjithë gjyqtarët e tjerë janë me dy vlerësime. Ndërsa për ngritjen në detyrë, në ndryshim nga lëvizja paralele, konsiderohen dy vlerësime vetëm ato pas vetting-ut.

Klodian Kurushi: Pas gradimit.

Irena Plaku (pa mikrofon ndezur): Dhe nuk mund t'i bëhet tjetër.

Ndërsa të gjithë kandidatët e tjerë janë me dy.

Albens Tabaku (pa mikrofon ndezur): Në dispozitiv duhet të ishte e rrëzuar kërkesa apo duhet të ishte...

Klodian Kurushi: Shiko, ai nuk është përfshirë në listën e kandidatëve që mund t'i bëhej vlerësimi i dytë. Kandidatët që mund të ngrihen në detyrë detyrimisht duhet të kenë dy vlerësime dhe detyrimisht vlerësimi i parë i tyre është ai i gradimit. Nuk heqim dorë nga 2013-2016, për gjyqtarët që kanë kaluar procesin e rivlerësimit kalimtar, jo për të rinjtë. Zoti {...} është një gjyqtar i cili e ka kaluar procesin e rivlerësimit kalimtar. Nuk është i bërë gradimi sepse shkoi në Shkollën e Magjistraturës dhe Shkolla e Magjistraturës e bëri vlerësimin, vlerësim i cili u konfirmua nga KPK-ja. Dhe thamë, në 2021-in iu bë vlerësimi "Mirë" atij. Vlerësimi i përshpejtuar për vitin 2022 nuk mund t'i bëhej sepse duhet të kalojë një afat prej tre vitesh. Kështu që thamë me atë vendim të vitit 2023, vendosëm që ai nuk përfshihet në listën e kandidatëve që mund t'i bëhet vlerësimi i dytë i përshpejtuar. Ky kriter bën që zoti {...} të mos vijojë më tej garën për ngritjen në detyrë pavarësisht se ai nuk ka hequr dorë, por është shprehur Këshilli dhe ka thënë që z. {...} nuk mund t'i bëhet vlerësimi i dytë.

(Disa nga anëtarët flasin pa ndezur mikrofonin.)

Nuk ka ngritur pretendime dhe nuk e ka ankimuar.

Gjithsesi nuk e ka ankimuar si çështje.

(Disa nga anëtarët flasin pa ndezur mikrofonin.)

Ai gjyqtari që e kemi çuar në një rast, ai e kishte kaluar gradimin. Vetëm nuk i bëhej dot... Ndërsa ky, s'i bëhet fare vlerësim dhe duhet gradim.

Dakord?

Kështu që janë këto kritere që e përjashtojnë nga mundësia për të vijuar garën.

Kështu që, potencialisht, megjithëse ai ka katër kërkesa, për tre prej tyre mund të vijojë procedura sepse ne si Këshill jemi shprehur që atij nuk i bëhet vlerësimi i dytë.

Ky ishte rasti i zotit {...}.

Dhe nuk është me katër potencialisht kërkesa, por është tre.

Tani, rasti i dytë është rasti i zotit {...}.

Ai ka aplikuar edhe më parë për lëvizje paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe Durrës për pozicionet nr. 73/2024; 78/2024; 83/2024. Zoti {...} me paraqitjen e aplikimit të ri për pozicionin nr. 489, ka hequr dorë nga pozicioni nr.83/2024 për Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës. Kështu që ai ka tre. Pra ka pasur tre. Heq dorë nga njëri dhe ka sjellë një kërkesë të re.

Zoti {...} ka aplikuar edhe më parë për lëvizje paralele. Aktualisht ka në proces pozicionet nr.14/2023 dhe nr. 240/2024. Përveç këtyre dy pozicioneve ai ka paraqitur 3 (tre) aplikime të reja për pozicionet nr. 491, 492 dhe nr. 493. Bazuar në nenin 43/5 të Ligjit 96/2016 “Për statusin”, ku parashikohet se: “Pas shpalljes së procedurës së lëvizjes paralele, magjistrati mund të kandidojë për jo më shumë se tri pozicione të lira, që janë në proces. Nëse magjistrati kandidon për më shumë se tri pozicione të lira në proces, kandidime të vlefshme konsiderohen ato të bëra më përpara në kohë, ose në rastin e shumë kandidimeve në të njëjtën kohë, ato sipas radhës kronologjike të pozicioneve të shpallura, duke filluar nga ai i shpallur më përpara. Magjistrati që kandidon për më shumë se një pozicion, bën renditjen e tyre sipas preferencës.”. Rezulton se z. {...} (dhe është konkluzioni ynë) do të ketë të vlefshëm për aplikim vetëm pozicionin nr. 491. Dy i ka të vlefshme (që janë të më përparshmet) sipas nenit 49/3 i ligjit, ato që janë më përpara në kohë ose në rendin kronologjik ato që janë më përpara në renditje. Më përpara në kohë janë ato që ai i ka bërë tashmë dhe jemi në proces verifikimi. Në hapjen e vendeve të fundit zoti {...} ka bërë tre kërkesa të reja dhe dy që i ka pasur përpara janë pesë në total. Pesë kërkesa në procedurat e lëvizjes paralele. Do merren në konsideratë tre, -thotë neni 43/5. Kështu që dy të vjetrat që meqenëse ai nuk ka shprehur preferencën do jenë në konsideratë dhe do merren në konsideratë nga rendi kronologjik i pari në kohë që është ajo që thashë unë, që është 491.

Sa i përket kandidatës znj. {...}, ajo ka aplikuar edhe më parë për pozicione të lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë. Ka të vlefshëm pozicionin nr. 501 të Gjykatës kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (janë verifikuar kriteret formale). Ka hequr dorë nga pozicionet e lëvizjeve paralele Tiranë nr. 76, 81 (kualifikuar) dhe ka paraqitur

dy aplikime të reja në pozicionet nr. 491 dhe nr. 493. Pra ka pasur tre, një për GJKKO, dy për lëvizje paralele në Tiranë. Ka hequr dorë nga lëvizjet paralele të mëparshme dhe ka paraqitur dy të reja (491 dhe 493). Në total ka tre kërkesa.

Vazhdojmë më tej. Kandidatit z. {...} ka aplikuar edhe më parë për lëvizje paralele. Nga pozicionet për të cilat ishte kualifikuar ose ishte në proces ai kishte gjithsej paraprakisht tre nr.79, 80, 81, të vitit 2024; ai ka paraqitur kërkesë për heqje dorë, duke paraqitur dy aplikime të reja, konkretisht nr. 492 dhe nr. 493. Ka hequr dorë nga tre të mëparshmet dhe ka paraqitur dy të reja (492, 493).

Në pozicionin nr. 490 vërehet se nuk ka garë për kandidatët që kanë ose që mund të kenë 2 (dy) vlerësime. Bashkëlidhur është edhe tabela që e kemi paraqitur.

490-ta është pozicion në fushën e së drejtës civile. E keni, në fund të relacionit keni edhe tabelën përkatëse.

Vërehet se nuk ka në garë kandidatë që kanë ose mund të kenë 2 (dy) vlerësime. Për rrjedhojë për këto pozicione Këshilli duhet të vijojë me verifikimin për kandidatët me 1 (një) vlerësim. Po të kishte me dy, do ta kufizonim verifikimin vetëm tek kandidati me dy vlerësime. Nuk ka. Fillojmë për ata që janë me një.

Në Kreun IV të vendimeve respektive nr. 84 dhe nr. 86 të vitit 2024, Këshilli ka përcaktuar edhe procedurat përkatëse që do të ndiqet si më poshtë.

Procedurat janë ato që unë i thashë edhe për ato që janë me dy vlerësime. Nuk po i lexoj.

Këshilli, me vendimin e datës 24.09.2024 ndër të tjera ka vendosur: “Miratimin e listës së gjyqtarëve që kanë ose mund të kenë një vlerësim sipas Skemës së Re të Vlerësimit, për efekt të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele.

Lista e gjyqtarëve që kanë 1 (një) vlerësim (ato që miratuam neve në fillim sot):
1. {...}, gjyqtar i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan. 2. {...}, gjyqtar i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës (këto kanë nga një vlerësim).

Lista e gjyqtarëve që mund të kenë 1 (një) vlerësim: z. {...}, z. {...}, znj. {...}, znj. {...}, z. {...}, znj. {...}, znj. {...}, z. {...}, znj. {...} dhe z. {...}.

Në pozicionin nr. 490/ të vitit 2024 kandidatët me 1 (një) vlerësim janë këta që unë i përmenda: z. {...}, z. {...}, z. {...}, znj. {...}, z. {...}, znj. {...}.

E thashë, sa i përket z.{...} ai ka aplikuar edhe më parë për lëvizje paralele. Ka hequr dorë nga dy pozicionet e mëparshme 74, 78 në Tiranë dhe ka paraqitur dy aplikime të reja që janë 489 dhe 490. Për njërin pozicion do t'i fillojnë verifikimet. Për tjetrin situata është “pending” pasi janë në garë, do fillojë verifikimi për kandidatët që janë me dy vlerësime ose që mund t'u bëhen dy vlerësime.

Sa i përket kandidatit z. {...}, ai ka aplikuar edhe më parë për lëvizje paralele dhe ka në proces pozicionet nr. 238 dhe nr. 239 (i kualifikuar) dhe nr. 240 (pozicioni që nuk ka filluar procedura e verifikimit për kandidatët me 1 vlerësim, se në pozicionin 240 ka kandidatë që kanë dy vlerësime). Ky aplikant ka hequr dorë nga pozicioni nr.238 dhe i mbesin dy që ka pasur përpara (239, 240) si dhe pozicioni i ri për të cilin ai ka bërë edhe aplikimin.

Sa i përket zonjës {...}, ajo ka aplikuar edhe më parë për lëvizje paralele për pozicionet 73, 78, 238. Me paraqitjen e aplikimit të ri (490) ajo ka hequr dorë nga pozicioni nr. 73. Pra në total ajo aktualisht ka 3 aplikime.

Sa i përket kandidatit z. {...}, ai ka aplikuar edhe më parë kërkesë për lëvizje paralele për pozicionet 76, 78, 239. Me paraqitjen e aplikimit të ri (490) ai ka hequr dorë nga pozicioni nr. 239.

Sa i përket kandidates znj. {...}, ajo ka aplikuar edhe më parë për lëvizje paralele për pozicionet 238, 239 (e kualifikuar) dhe pozicionin nr. 240 (pozicioni 240 është një procedurë që nuk ka filluar verifikimi për kandidatët me 1 vlerësim sepse në atë pozicion ka kandidatë në garë që kanë dy vlerësime). Me paraqitjen e aplikimit të ri (490) ajo ka hequr dorë nga pozicioni nr. 238.

Për kandidatët të cilët kanë hequr dorë nga pozicionet e lëvizjes paralele dhe përfshihen në kategoritë e kandidatëve të cilët nuk janë thirrur për verifikim (pasi gara ka filluar për kandidatët me 2 vlerësime), janë këto kandidatë: z. {...}, tërhiqet nga pozicionet nr. 74, 78; znj. {...} tërhiqet nga pozicioni nr. 73. Për këta kandidatë përfundon procedura pa një vendim përfundimtar (për ato raste ku ato kanë hequr dorë nga kërkesat e tyre). Procedura pa një vendim përfundimtar për këta kandidatë do t'i përfundojë anëtarit të cilit do t'i bie në short kandidati që do të bëjë verifikimet e kritereve ligjore, pra për zotin {...} dhe znj. {...}.

Struktura e projektvendimit. Është bashkëlidhur relacionit që përmenda. Anëtarët janë njohur. Nuk po i lexoj edhe një herë sepse pastaj kjo do të jetë pjesë e procesit të diskutimit dhe votimit.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Kurushi

Ka diskutime për sa u parashtrua?

Meqenëse nuk ka diskutime, ftoj administratën për të hedhur shortin.

Procedura e hedhjes së shortit si vijon:

Në enën e parë të qelqit vendosen shiritat me emrat e relatorëve: z. Klodian Kurushi (për tre kandidatë), z. Albens Tabaku (për katër kandidatë), z. Markelian Koça (për katër kandidatë).

Në enën e dytë të qelqit vendosen shiritat me emrat e gjyqtarëve: znj. {...}, z. {...}, z. {...}, z. {...}, z. {...}, z. {...}, z. {...}, z. {...}, znj. {...}.

Procedura e përzgjedhjes së goglave si vijon:

Përzgjidhet gogla e parë nga relatorët. I përzgjedhur nga gogla e parë rezulton z. Albens Tabaku. Zoti Tabaku do të jetë relator për katër nga gjyqtarët të cilët përzgjidhen sipas këtij rendi: z. {...}, z. {...}, znj. {...}, znj. {...}.

Përzgjidhet gogla e dytë nga relatorët. I përzgjedhur nga gogla e dytë rezulton z. Klodian Kurushi. Zoti Kurushi do të jetë relator për tre nga gjyqtarët të cilët përzgjidhen sipas këtij rendi: z. {...}, z. {...}, z. {...}.

Përzgjidhet gogla e tretë dhe e fundit nga relatorët. I përzgjedhur nga gogla e tretë rezulton z. Markelian Koça. Zoti Koça do të jetë relator për katër nga gjyqtarët të cilët përzgjidhen sipas këtij rendi: z. {...}, z. {...}, z. {...} dhe znj. {...}.

Ilir Rusi: Faleminderit!

Ka diskutime për hedhjen e shortit?

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë në votimin e projektvendimit të përditësuar me të dhënat e shortit të sapo hedhur.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Bledar Bajri: Dakord.

Albens Tabaku: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit në procedurat e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, shpallur me vendimet nr. 489, 490, 491, 492, 493, datë 13.09.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, sipas relacionit dhe përmbajtjes së shortit mori vendimin përkatës.

Gjithashtu ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 8 shtesë e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 24.09.2024)

Pika 9 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin e relatorit në procedurat e verifikimit të kancelarëve në detyrë dhe kualifikimit dhe vijimin e procedurave të emërimit në shërbimin civil gjyqësor të kandidatëve që kanë përfunduar programin e formimit fillestar për ndihmës ligjor në Shkollën e Magjistraturës, viti akademik 2023-2024, të papërfunduara për shkak të mbarimit të mandatit të anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, znj. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.⁹

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:14 dhe mbaroi në orën 15:08.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. <i>Ilir Rusi</i> | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| 2. <i>Klodian Kurushi</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 3. <i>Irena Plaku</i> | <i>(anëtare)</i> |
| 4. <i>Gentiana Muçaj</i> | <i>(anëtare)</i> |
| 5. <i>Ridvan Hado</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 6. <i>Bledar Bajri</i> | <i>(anëtar)</i> |

⁹ Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e teta sipas rendit të ditës.

7. *Albens Tabaku* (anëtar)
8. *Markelian Koça* (anëtar)
9. *Yllka Rupa* (anëtare)

Shënim: Nuk morën pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor *znj. Naureda Llagami*, si dhe anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Emona Muçi*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
2. *Luan Dibra, Gentiana Agushi, Maela Alicanaj, Rezarta Taushani, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
3. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.*
4. *Petrika Thano, MCA-PRESS.*
5. *Sidorela Driçi, AIS Instituti Shqiptar i Shkencës, Open Data.*
6. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

9. Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin e relatorit në procedurat e verifikimit të kancelarëve në detyrë dhe kualifikimit dhe vijimin e procedurave të emërimit në shërbimin civil gjyqësor të kandidatëve që kanë përfunduar programin e formimit fillestar për ndihmës ligjor në Shkollën e Magjistraturës, viti akademik 2023-2024, të papërfunduara për shkak të mbarimit të mandatit të anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. {...}*”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

Ilir Rusi: Vazhdojmë me një pikë tjetër që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për caktimin e relatorit në procedurat e verifikimit të kancelarëve në detyrë dhe kualifikimit dhe vijimin e procedurave të emërimit në shërbimin civil gjyqësor [...]”. Është përgatitur relacioni nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit. Për më tej fjalën relatorit z. Hado.

Ridvan Hado: Faleminderit!

Relacion mbi projektvendimin “Për caktimin e relatorit në procedurat e verifikimit të kancelarëve në detyrë dhe kualifikimit dhe vijimin e procedurave të emërimit në shërbimin civil gjyqësor të kandidatëve që kanë përfunduar programin e formimit fillestar për ndihmës ligjor në shkollën e magjistraturës, viti akademik 2023-2024, të papërfunduara për shkak të mbarimit të mandatit të anëtarit të këshillit të lartë gjyqësor, znj. {...}”.

Zonja {...} dhe zoti {...} janë kancelarë në detyrë në gjykatat e posaçme për korrupsionin dhe krimin e organizuar. Ndërsa, znj. {...}, znj. {...} dhe z. {...} janë kandidatë për ndihmës ligjorë, që kanë përfunduar programin e formimit fillestar për ndihmës ligjorë, në Shkollën e Magjistraturës, në vitin akademik 2023-2024.

Në kushtet kur me vendimin nr. 362, datë 29.07.2024 Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur deklarin e mbarimit të mandatit dhe përfundimin e qëndrimit në detyrë të znj. {...} si anëtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor, është e nevojshme që për vazhdimin e procedurave të verifikimit për znj. {...}, z. {...}, znj. {...}, znj. {...} dhe z. {...} të caktohen relatorë të rinj.

Për dy kancelarët në detyrë znj. {...} dhe z. {...} procedura e verifikimit të tyre i është paraqitur mbledhjes plenare të Këshillit të Lartë Gjyqësor në datën 03.07.2024, dhe është shtyrë për në mbledhjen e ardhshme.

Për tre kandidatët që kanë përfunduar programin e formimit fillestar për ndihmës ligjor në Shkollën e Magjistraturës, në vitin akademik 2023-2024 znj. {...}, znj. {...} dhe z. {...} procesi ndodhet aktualisht në fazën e procedurës së kualifikimit dhe vijimin e procedurës të emërimit në shërbimin civil gjyqësor. Konkretisht:

Znj. {...} është kualifikuar në procesin e verifikimit të kriterit të pasurisë dhe figurës, me vendimin e KLGJ-së nr. 326, datë 03.07.2024;

Znj. {...} është kualifikuar në procesin e verifikimit të kriterit të pasurisë dhe figurës, me vendimin e KLGJ-së nr. 324, datë 03.07.2024;

Z. {...} është kualifikuar në procesin e verifikimit të kriterit të pasurisë dhe figurës, me vendimin e KLGJ-së nr. 469, datë 31.07.2024.

Në vijim, Shkolla e Magjistraturës me shkresën nr. {...} prot., datë 01.08.2023, ka përcjellë vendimin e saj me nr. 29, datë 30.07.2024, “Për vlerësimin përfundimtar të kandidatëve për ndihmës ligjor në Programin e Formimit Fillestar”, duke vendosur miratimin e listës së kandidatëve fitues, duke i renditur sipas pikëve që ata kanë marrë në vlerësimin përfundimtar në Programin e Formimit Fillestar.

Lidhur me verifikimin e kandidatëve në kuadër të rekrutimit si dhe të emërimit, përfshirë edhe të kancelarëve dhe ndihmësve ligjorë, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka miratuar procedurat me vendimin nr. 424, datë 12.10.2020. (*lapsus viti 2024 që citon z. Hado*).

Lidhur me strukturën e projektvendimit, kalojmë pra tek struktura e projektvendimit. Ajo përbëhet nga 3 pika.

Në pikën 1 të projektvendimit parashikohet caktimi i relatores znj. Yllka Rupa në procedurat e verifikimit të kancelarëve në detyrë, të papërfunduara për shkak të mbarimit të mandatit të anëtares së Këshillit të Lartë Gjyqësor, znj. {...}.

Në pikën 2 të projektvendimit parashikohet caktimi i relatores znj. Yllka Rupa në procedurat e kualifikimit dhe vijimin e procedurave të emërimit në shërbimin civil gjyqësor të kandidatëve që kanë përfunduar programin e formimit fillestar për ndihmës ligjor në Shkollën e Magjistraturës, viti akademik 2023-2024, të papërfunduara për shkak të mbarimit të mandatit të znj. {...}.

Ndërsa në pikën 3 të projektvendimit përcaktohet detyrimi i njoftimit të vendimit kancelarëve në detyrë dhe kandidatëve për ndihmës ligjorë, sipas pikës 65 të vendimit nr. 424, datë 12.10.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Së fundmi, në projektvendim përcaktohet dhe hyrja në fuqi e tij, konkretisht menjëherë me botimin në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ju faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Hado!

Ka diskutime?

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë në votimin e projektvendimit.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Bledar Bajri: Dakord.

Albens Tabaku: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Illir Rusi: Dakord.

Vendim “Për caktimin e relatorit në procedurat e verifikimit të kancelarëve në detyrë dhe kualifikimit dhe vijimin e procedurave të emërimit në shërbimin civil gjyqësor të kandidatëve që kanë përfunduar programin e formimit fillestar për ndihmës ligjor në Shkollën e Magjistraturës, viti akademik 2023-2024, të papërfunduara për shkak të mbarimit të mandatit të anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, znj. {...}”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi sipas përmbajtjes së relacionit duke përcaktuar në të ardhmen relatore znj. Yllka Rupa.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 9 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 24.09.2024)

Pika 10 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin pa vendim përfundimtar të procedurës së vlerësimit etik dhe profesional, për periudhën e vlerësimit 2017-2019, për gjyqtarin {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale (relatore ishte znj. Emona Muçi).¹⁰

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:14 dhe mbaroi në orën 15:08.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 3. Irena Plaku | (anëtare) |
| 4. Gentiana Muçaj | (anëtare) |
| 5. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 6. Bledar Bajri | (anëtar) |
| 7. Albens Tabaku | (anëtar) |
| 8. Markelian Koça | (anëtar) |
| 9. Yllka Rupa | (anëtare) |

¹⁰ Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e nënta sipas rendit të ditës.

Shënim: Nuk morën pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor *znj. Naureda Llagami*, si dhe anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Emona Muçi*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

2. Luan Dibra, Gentiana Agushi, Maela Alicanaj, Rezarta Taushani, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.

3. Denisa Varfi dhe Entela Dobi përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.

4. Petrika Thanu, MCA-PRESS.

5. Sidorela Driçi, AIS Instituti Shqiptar i Shkencës, Open Data.

6. Staf nga administrata e KLGJ-së.

RENDI I DITËS:

10. Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin pa vendim përfundimtar të procedurës së vlerësimit etik dhe profesional, për periudhën e vlerësimit 2017-2019, për gjyqtarin {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale (relatore ishte *znj. Emona Muçi*).

Ilir Rusi: Në vijim vazhdojmë me shqyrtimin e projektvendimit “Për përfundimin pa vendim përfundimtar të procedurës së vlerësimit etik dhe profesional, për periudhën e vlerësimit 2017-2019, për gjyqtarin {...}”, për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale. Për më tej fjalën relatores *znj. Plaku*.

Irena Plaku: Faleminderit!

Atëherë, po ju parashtroj në mënyrë të përmbledhur relacionin mbi projektvendimin “Për përfundimin pa vendim përfundimtar të procedurës së vlerësimit etik dhe profesional, për gjyqtarin {...}”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në neni 85 e vijues të ligjit “Për statusin”, si dhe vendimin nr. 645, datë 23.12.2020 “Programi i vlerësimit për vitin 2021”, si dhe me vendimin nr. 371, datë 13.09.2022, ka vendosur fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit {...}, për periudhën e vlerësimit 2017-2019. Janë përcaktuar relatori dhe nëpunësi përgjegjës po ky vendim ka ndryshuar për shkak edhe të ndryshimit të komisioneve të përhershme.

Me shkresat nr. {...} prot., datë 19.09.2022, me shkresën nr. {...} prot., nr. {...} prot., është kërkuar përkatësisht... është bërë procedura për administrimin e burimeve të vlerësimit për gjyqtarin {...}. Është dërguar formulari i integruar i vetëvlerësimit, etj.

Me vendimin nr. 91, datë 20.02.2024, “Për caktimin e relatorit në procedurat e vlerësimit [...]”, është caktuar si relatore znj. Emona Muçi. Ky relacion është dërguar nga zonja Muçi, por për shkak të pamundësisë së saj po lexohet nga ana ime.

Gjatë ecurisë së procedurës së vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit, me vendimin nr.692, datë 28.07.2023, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ka vendosur shkarkimin e tij nga detyra. Në këto kushte Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, mbështetur në nenin 62, nenin 4 të ligjit nr. 115/2016 si dhe nenin 66, pika 1 të Kodit të Procedurave Administrative, ka vendosur pezullimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional për gjyqtarin {...}.

Ndaj vendimit të pezullimit gjyqtari nuk ka paraqitur ankim në mbledhje plenare, megjithëse i është njoftuar në datë 20.10.2023.

Mbi ankimin e paraqitur nga subjekti i rivlerësimit ndaj vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, Kolegji i Posaçëm i Apelimit me vendimin nr.256, datë 29.07.2024 ka vendosur: Lënien në fuqi të vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për shkarkimin e subjektit të rivlerësimit {...}.

Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekte të menjëhershme.

Bazuar në pikën 7, të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, është përcaktuar: “Moskalimi me sukses i procesit të rivlerësimit përbën shkak për mbarimin e menjëhershëm të ushtrimit të detyrës, krahas shkaqeve të parashikuara në Kushtetutë”. Bazuar në nenin 66 të Ligjit nr.84/2016 parashikohet se: Vendimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, që vendos shkarkimin, parashikohet që ka efekt të menjëhershëm.

Në këto kushte, duke qenë se gjyqtari është shkarkuar dhe ky vendim ka hyrë në fuqi menjëherë pas marrjes së tij, gjyqtari ka humbur statusin e gjyqtarit (d.mt.th. z. {...}) ka humbur statusin e gjyqtarit).

Sa më lart, Komisioni vlerëson se moskalimi me sukses i procesit të rivlerësimit të gjyqtarit {...} passjell menjëherë mbarimin e statusit të tij, rrethanë kjo që përbën shkak për përfundimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional.

Në ligjin “Për statusin” nuk ka një parashikim për mënyrën e përfundimit, por në nenin 7 të vendimit të KLGJ nr.263, datë 21.11.2019, parashikohet përfundimi pa vendim përfundimtar i procedurës së vlerësimit në rastet e mbarimit të statusit.

Në referim të analizës së mësipërme, KVEVP-ja i ka propozuar mbledhjes plenare miratimin e projektvendimit ku në pikën 1 të përcaktohet përfundimi i procedurës së vlerësimit etik dhe profesional për 2017-2019, për gjyqtarin {...}, për shkak të mbarimit të statusit të magjistratit.

Në pikën 2 përcaktohet që një kopje e vendimit t’i njoftohet gjyqtarit {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të ligjit “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”.

Në pikën 3 parashikohet e drejta e ankimit në gjykatë ndaj këtij akti administrativ të Këshillit.

Së fundi, parashikohet hyrja në fuqi menjëherë pasi botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zonja Plaku!

Keni diskutime?

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë në votimin e projektvendimit.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Bledar Bajri: Dakord.

Albens Tabaku: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Illir Rusi: Dakord.

Vendim “Për përfundimin pa vendim përfundimtar të procedurës së vlerësimit etik dhe profesional, për periudhën e vlerësimit 2017-2019, për gjyqtarin {...}”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi sipas asaj çfarë u relatua.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit.

* * *

(Pika 10 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 24.09.2024)

Pika 11 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për shfuqizimin e vendimit nr. 436 datë 19.07.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor për pezullimin e procedimit disiplinor të filluar ndaj ish magjistratit {....} dhe vijimin e shqyrtimit të tij”, i përgatitur nga Komisioni Disiplinor (relator z. Ridvan Hado).¹¹

Pika 12 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për shfuqizimin e vendimit nr. 437 datë 19.07.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor për pezullimin e procedimit disiplinor të filluar ndaj ish magjistratit {....} dhe vijimin e shqyrtimit të tij”, i përgatitur nga Komisioni Disiplinor (relator z. Ridvan Hado).¹²

Pika 13 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për shfuqizimin e vendimit nr. 438 datë 19.07.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor për pezullimin e procedimit disiplinor të filluar ndaj ish magjistratit {....} dhe vijimin e shqyrtimit të tij”, i përgatitur nga Komisioni Disiplinor (relator z. Ridvan Hado).¹³

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:14 dhe mbaroi në orën 15:08.

¹¹ Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e dhjeta sipas rendit të ditës.

¹² Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e njëmbëdhjeta sipas rendit të ditës.

¹³ Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e dymbëdhjeta sipas rendit të ditës.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. *Ilir Rusi* (zëvendëskryetar)
2. *Klodian Kurushi* (anëtar)
3. *Irena Plaku* (anëtare)
4. *Gentiana Muçaj* (anëtare)
5. *Ridvan Hado* (anëtar)
6. *Bledar Bajri* (anëtar)
7. *Albens Tabaku* (anëtar)
8. *Markelian Koça* (anëtar)
9. *Yllka Rupa* (anëtare)

Shënim: Nuk morën pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor *znj. Naureda Llagami*, si dhe anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Emona Muçi*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
2. *Luan Dibra, Gentiana Agushi, Maela Alicanaj, Rezarta Taushani, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
3. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.*
4. *Petrika Thano, MCA-PRESS.*
5. *Sidorela Driçi, AIS Instituti Shqiptar i Shkencës, Open Data.*
6. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

11. Shqyrtimi i projektvendimit “Për shfuqizimin e vendimit nr. 436 datë 19.07.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor për pezullimin e procedimit disiplinor të filluar ndaj ish magjistratit {....} dhe vijimin e shqyrtimit të tij”, i përgatitur nga Komisioni Disiplinor (relator z. Ridvan Hado).

12. Shqyrtimi i projektvendimit “Për shfuqizimin e vendimit nr. 437 datë 19.07.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor për pezullimin e procedimit disiplinor të filluar ndaj ish magjistratit {...} dhe vijimin e shqyrtimit të tij”, i përgatitur nga Komisioni Disiplinor (relator z. Ridvan Hado).

13. Shqyrtimi i projektvendimit “Për shfuqizimin e vendimit nr. 438 datë 19.07.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor për pezullimin e procedimit disiplinor të filluar ndaj ish magjistratit {...} dhe vijimin e shqyrtimit të tij”, i përgatitur nga Komisioni Disiplinor (relator z. Ridvan Hado).

Ilir Rusi: Më tej vazhdojmë me një pikë tjetër që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për shfuqizimin e vendimit nr. 436 datë 19.07.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor për pezullimin e procedimit disiplinor të filluar ndaj ish magjistratit {...} dhe vijimin e shqyrtimit të tij”. Për më tej fjalën relatorit.

Dhe në vijim është një pikë tjetër që ka të bëjë me shfuqizimin e vendimit nr. 437 dhe shfuqizimin e vendimit nr. 438, po për magjistratin {...}.

Për më tej fjalën relatorit z. Hado.

Ridvan Hado: Faleminderit!

Nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë janë depozituar pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor në datë 24.11.2022 si dhe në datë 01.03.2023, tre kërkesa për procedimin disiplinor të magjistratit {...} me detyrë gjyqarar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës. Në këto kërkesa Inspektori i Lartë i Drejtësisë në dy kërkesa ka kërkuar “pezullimin nga detyra për një periudhë 2-vjeçare”, ndërsa në kërkesën e tretë caktimin e masës disiplinore “vërejtje publike”. Këshilli ka vendosur me vendimin në seancë dëgjimore të kërkesave të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe gjatë seancave magjistrati {...} nuk është paraqitur duke sjellë në mënyrë kronologjike raportin mjeko-ligjor me diagnozën “i alkoolizuar”.

Në këto kushte Këshilli me vendimin 223, datë 08.05.2023 vendosi fillimin e procedurës në referim të nenit 67 të ligjit “Për statusin”, verifikimin e procedurës për të verifikuar mundësitë fizike dhe mendore të magjistratit {...} për vazhdimin e detyrës,

92

dhe ia ngarkoi Komisionit të Zhvillimit të Karrierës. Ndërkohë, komisioni mjekësor për caktimin e aftësisë në punë, i Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Shkodër, e nxori të paaftë për punë për një periudhë njëvjeçare. Në këto kushte ai vendimi ngeli pa objekt dhe u deklarua i përfunduar pa vendim përfundimtar.

Gjithashtu, ndërkohë KEMP-i ishte për një periudhë njëvjeçare. Nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor në kushtet e sipërcituara u vendos pezullimi i procedimit disiplinor për magistratin, për të tre kërkesat e Inspektorit, të tre çështjeve të magistratit {....}.

Nga ana tjetër, magistrati {....} ishte në proces rivlerësimi, pra në procesin e vetting-ut, dhe me vendimin 692, datë 29.07.2023 u shkarkua nga detyra, vendim i cili mbi ankimin e magistratit u la në fuqi me vendimin {...} të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, datë 29.07.2024.

Në këto rrethana, në kushtet kur shkak u pezullimit ka rënë dhe gjithashtu edhe në kushtet e sipërcituara, Komisioni Disiplinor vendosi në mbledhjen e saj, duke e konsideruar pra vendimin e pezullimit që ka rënë shkak, vendosi që ta kalojë çështjen në seancë plenare duke i propozuar këtë projektvendim mbledhjes plenare. Pra shfuqizimin e pezullimit të procedimit disiplinor 3 të vitit 2022, si dhe 1 dhe 2 të vitit 2023.

Projekti është i strukturuar në tre pika. Në pikën e parë pra, që sapo e thashë Shfuqizimi i vendimit nr. 436, datë 19.07.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për pezullimin e procedimit disiplinor të filluar ndaj magistratit z. {....}”, po ashtu edhe procedimet 437 dhe 438.

Në pikën 2 të projektvendimit propozohet mbi vijimin e shqyrtimit të procedimit disiplinor të filluar ndaj magistratit z. {....}, dhe caktimin e seancës dëgjimore për njoftimin e palëve.

Në pikën e 3 të projektvendimit është përcaktuar njoftimi si i magistratit ashtu edhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Dhe së fundmi edhe momenti i hyrjes në fuqi.

Nga ana tjetër duhet të kemi parasysh që afati i caktimit të seancës është njëmuajor dhe ndërkohë duhet njoftuar afati i njoftimit 15 ditë. Pra pas 15 ditëve, por pa kaluar afati njëmuajor duhet të caktojmë seancën dëgjimore.

Ilir Rusi: Në vijim të parashtrësive, ju lutem zoti relator propozimin në lidhje me datën dhe orën për të tria procedimet.

Ridvan Hado: Faleminderit edhe një herë. Unë propozoj që mbledhjen mundësisht ta caktojmë në datë 16 tetor, në ora 11:00, në 11:15, dhe në 11:30, për të tre procedimet në ngarkim të magjistratit {...}. Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit!

Ka diskutime për sa u parashtrua?

(Nuk ka diskutime.)

Atëherë, kalojmë në votimin e projektvendimit.

Fillimisht projektvendimi që ka të bëjë me shfuqizimin e vendimit nr. 436.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Bledar Bajri: Pro.

Albens Tabaku: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për shfuqizimin e vendimit nr. 436 datë 19.07.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor për pezullimin e procedimit disiplinor të filluar ndaj ish magjistratit {...} dhe vijimin e shqyrtimit të tij”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi sipas relacionit. Dhe caktimin e seancës dëgjimore më datë 16.09.2024, ora 11:00.

Ilir Rusi: Vazhdojmë.

Keni diskutime për shfuqizimin e vendimit nr. 437?

(Nuk ka diskutime.)

Nuk ka! Vazhdojmë në votim.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Bledar Bajri: Dakord.

Albens Tabaku: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për shfuqizimin e vendimit nr. 437 datë 19.07.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor për pezullimin e procedimit disiplinor të filluar ndaj ish magjistratit {...} dhe vijimin e shqyrtimit të tij”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi sipas relacionit. Dhe caktimin e seancës dëgjimore më datë 16.09.2024, ora 11:15.

Ilir Rusi: Vazhdojmë me projektvendimin për shfuqizimin e vendimit nr. 438.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Bledar Bajri: Dakord.

Albens Tabaku: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për shfuqizimin e vendimit nr. 438 datë 19.07.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor për pezullimin e procedimit disiplinor të filluar ndaj ish magjistratit {...} dhe vijimin e shqyrtimit të tij”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi sipas relacionit. Dhe caktimin e seancës dëgjimore më datë 16.09.2024, ora 11:30.

* * *

(Pika 11, 12, 13 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 24.09.2024)

Pika 14 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për mosfillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin), për periudhën e vlerësimit 2013-2016, për gjyqtaren {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale (relatore ishte znj. Emona Muçi).¹⁴

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:14 dhe mbaroi në orën 15:08.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. <i>Ilir Rusi</i> | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| 2. <i>Klodian Kurushi</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 3. <i>Irena Plaku</i> | <i>(anëtare)</i> |
| 4. <i>Gentiana Muçaj</i> | <i>(anëtare)</i> |
| 5. <i>Ridvan Hado</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 6. <i>Bledar Bajri</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 7. <i>Albens Tabaku</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 8. <i>Markelian Koça</i> | <i>(anëtar)</i> |

¹⁴ Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e trembëdhjeta sipas rendit të ditës.

Shënim: Nuk morën pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor *znj. Naureda Llagami*, si dhe anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Emona Muçi*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
2. *Luan Dibra, Gentiana Agushi, Maela Alicanaj, Rezarta Taushani, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
3. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.*
4. *Petrika Thanu, MCA-PRESS.*
5. *Sidorela Driçi, AIS Instituti Shqiptar i Shkencës, Open Data.*
6. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

14. Shqyrtimi i projektvendimit “Për mosfillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin), për periudhën e vlerësimit 2013-2016, për gjyqtaren {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale (relatore ishte *znj. Emona Muçi*).

Ilir Rusi: Në vijim vazhdojmë me shqyrtimin e projektvendimit “Për mosfillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin), për periudhën e vlerësimit 2013-2016, për gjyqtaren {...}”. Për më tej fjalën relatores *znj. Plaku*.

Irena Plaku: Faleminderit!

Atëherë Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenin 85 dhe 97 të ligjit nr. “Për statusin”, dhe vendimit nr.263, të vitit 2019 ka detyrimin të fillojë procedurën e vlerësimit etik për të gjithë gjyqtarët që kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit

kalimtar. Një ndër këto gjyqtare është edhe znj. {...}, gjyqtare e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Në Këshillin e Lartë Gjyqësor, janë administruar me shkresën me nr.{...} prot, datë 04.07.2024 dosja e Komisionit të posaçëm të rivlerësimit kalimtar, ku rezulton se është konfirmuar në detyrë me vendimin nr.45, datë 26.10.2023 të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

Pas shqyrtimit paraprak të dosjes ka rezultuar se gjyqtarja {...} është caktuar gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë, me dekretin nr. {...}, datë 16.09.2004 të Presidentit të Republikës, detyrë të cilën e ka ushtruar deri në datën 15.09.2010, datë në të cilën është emëruar Inspektore në Inspektoratin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, me vendimin nr. {...}, datë 15.09.2010 të ish-KLD-së.

Me vendimin nr.{...}, datë 16.12.2013 të ish-Këshilli të Lartë të Drejtësisë gjyqtares i është dhënë pëlqimi për të shërbyer si Avokate e Përgjithshme e Shtetit, detyrë të cilën e ka ushtruar deri në datën 31.10.2018. (*Zonja Plaku e citon 13.10.2018*) Pra gjatë kohës që përfshin edhe periudhën e rivlerësimit kalimtar.

Me vendimin nr.67, datë 06.02.2020, Këshilli i Lartë Gjyqësor e ka transferuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ku ushtron aktualisht detyrën.

Sa më sipër, për periudhën e vlerësimit tetor 2013-tetor 2016, rezulton se znj. {...} ka ushtruar përkohësisht detyrën në Inspektoratin e Lartë të Drejtësisë për një periudhë 2-mujore dhe më pas Avokate e Përgjithshme e Shtetit.

Në këto kushte, referuar dispozitave të ligjit “Për statusin”, nenin 70, pika 3 e ligjit “Për statusin”: (*pika 4*) “Magjistratët, të cilët janë komanduar në struktura të tjera dhe ruajnë statusin e magjistratit, vlerësohen sipas sistemit të vlerësimit ku janë komanduar”.

Referuar faktit se gjatë periudhës kalimtare të vlerësimit 2013-2016 gjyqtarja nuk ka asnjë vit përvojë profesionale si gjyqtare, kësaj të fundit nuk mund t’i kryhet një procedurë vlerësimi sipas rregullave të miratuara në ligjin “Për statusin” (nuk mund t’i bëhet gradimi).

Sa më sipër, në kushtet kur gjyqtarja për periudhën e vlerësimit, nuk rezulton të ketë ushtruar veprimtarinë profesionale për një kohëzgjatje minimale prej një viti, brenda

periudhës së vlerësimit 2013-2016, procedura e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin) është e pamundur.

Në nenin 97, të ligjit 115 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, parashikohet se: “Këshilli i Lartë Gjyqësor zbaton për aq sa është e mundur Kodin e Procedurës Administrative”. Në nenin 41 të Kodit të Procedurës Administrative parashikohet se: Organi publik është i detyruar të fillojë procedurën administrative kryesisht kur: a) ligji ose aktet nënligjore parashikojnë fillimin e procedurës;... . Ndërsa në rast se nuk e parashikojnë nuk mund të fillojë.

Në zbatim të nenit 41 të K.Pr.Administrative (*znj. Plaku e citon K.Pr.civile*) që rregullon këto raste dhe mënyrën e fillimit të një procedimi administrativ, në lidhje me nenin 171, pika 5 të ligjit “Për statusin”, procedura administrative me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit për gjyqtarët e konfirmuar në detyrë me vendim të formës së prerë, fillon nga Këshilli në mënyrë të detyrueshme sipas ligjit, në rastet kur plotësohen së paku këto kushte në mënyrë kumulative:

1) Gjyqtarët të kenë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar.

2) Periudha e stazhit profesional pranë Shkollës së Magjistraturës të mos përfshihet në kohën e punës si gjyqtar.

3) Koha/periudha e punës si gjyqtar me qëllim gradimi të jetë jo më pak se një vit.

Në rastin konkret, siç e relatuar më sipër, zonja {...} nuk ka ushtruar funksionin e gjyqtarit në periudhën e vlerësimit 2013-2016. Sa më sipër kjo procedurë nuk mund të fillojë.

Sa më sipër, Komisioni i Vlerësimit Etik dhe Profesional i propozon mbledhjes miratimin e këtij projektvendimi ku në pikën 1 përcaktohet mosfillimi i procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin) e gjyqtarës {...}, për periudhën 2013-2016, pasi koha e ushtrimit të detyrës, brenda periudhës së vlerësimit, është më e shkurtër.

Në pikën 2 përcaktohet që një kopje e vendimit të mosfillimit i njoftohet gjyqtarës.

Në pikën 3 parashikohet e drejta e ankimit ndaj këtij vendimi, akti administrativ individual.

Së fundi, përcaktohet hyrja në fuqi menjëherë sa botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit.

Relatoj se ndër të tjera gjyqtares i është njoftuar relacioni paraprakisht dhe nuk ka paraqitur qëndrim lidhur me këtë relacion.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit!

Ka diskutime?

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me votimin.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Bledar Bajri: Dakord.

Albens Tabaku: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për mosfillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin), për periudhën e vlerësimit 2013-2016, për gjyqtaren {...}”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi sipas relacionit përkatës.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi redaktohet për sigurimin e anonimatit.

* * *

(Pika 14 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 24.09.2024)

Pika 15 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 244 dhe nr.246, datë 02.05.2024, për kandidaten znj. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator ishte z. {...}).¹⁵

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:14 dhe mbaroi në orën 15:08.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 3. Irena Plaku | (anëtare) |
| 4. Gentiana Muçaj | (anëtare) |
| 5. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 6. Bledar Bajri | (anëtar) |
| 7. Albens Tabaku | (anëtar) |
| 8. Markelian Koça | (anëtar) |
| 9. Yllka Rupa | (anëtare) |

¹⁵ Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e katërmëdhjeta sipas rendit të ditës.

Shënim: Nuk morën pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor *znj. Naureda Llagami*, si dhe anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Emona Muçi*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

2. Luan Dibra, Gentiana Agushi, Maela Alicanaj, Rezarta Taushani, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.

3. Denisa Varfi dhe Entela Dobi përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.

4. Petrika Thano, MCA-PRESS.

5. Sidorela Driçi, AIS Instituti Shqiptar i Shkencës, Open Data.

6. Staf nga administrata e KLGJ-së.

RENDI I DITËS:

15. Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 244 dhe nr.246, datë 02.05.2024, për kandidaten *znj. {...}*”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator ishte z. {...}).

Ilir Rusi: Vazhdojmë me një pikë tjetër të rendit të ditës që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 244 dhe nr.246, datë 02.05.2024, për kandidaten *znj. {...}*”. Për më tej fjalën relatorit z. Kurushi.

Klodian Kurushi: Relacionin e radhës më takon ta lexoj unë megjithëse është përgatitur nga zoti {...}, për shkak se referuar shortit që bëmë ditën e sotme për ndarjen e kolegëve, anëtarë të Komisionit, jam caktuar si relator për vijimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore për kandidaten *zonjën {...}*.

Zonja {...} ka paraqitur kërkesë për t'u tërhequr nga pozicionet ku ajo ka kandiduar për pozicionet 244 dhe 246, datë 02.05.2024.

Këto pozicione i përkasin vendimeve të shpallura nga Këshilli i Lartë Gjyqësor kur ka hapur vakancat e lira për në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionet e lira në fushën e së drejtës civile.

Ka kandiduar edhe zonja {...} në këto pozicione. Më pas, pasi është bërë verifikimi i tre kritereve formale dhe pa përfunduar verifikimi i kritereve të pasurisë dhe figurës për të, zonja {...} ka paraqitur një kërkesë për t'u tërhequr nga kandidimi në këto pozicione. Kërkesa e zonjës {...} është protokolluar me aktin numër {...} prot. në Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe ajo është paraqitur në datë 09.07.2024. Zonja {...}, ndër të tjera, ka paraqitur kërkesën me këtë përmbajtje:

Unë e nënshkruara {...}, aktualisht gjyqtare në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, paraqes pranë jush kërkesën për të hequr dorë. Në lidhje me kërkesat e bëra nga ana ime për kandidimin në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për vendet e shpallura me nr. 244 dhe 246, datë 02.05.2024 nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Duke qenë se formulari i deklaramit të pasurisë në lidhje me këto vende nuk është plotësuar nga ana ime brenda afatit 21-ditor, paraqes kërkesën për heqje dorë nga kandidimi për këto dy vende, pra me numër 244, 246.

Ndodhur në këto rrethana është përgatitur relacioni përkatës, ku ne njoftohemi për tërheqjen dorë nga kandidatja dhe kështu që referuar më tej, nenit 64, pika 2 e Kodit të Procedurave Administrative si dhe në pikën 3 të nenit 97 të ligjit nr. 115, të vitit 2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, si dhe në pikën 6, seksioni B, kreu V i vendimit nr.75/2019, i propozojmë Këshillit përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e së drejtës civile të shpallur me vendim nr. 244 dhe 246 datë 02.05.2024, për kandidaten znj. {...}, për shkak të tërheqjes së saj nga kandidimi për këtë pozicion.

Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidates sipas kërkesave të nenit 98 të ligjit nr. 115/2016, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit z. Kurushi!

Ka diskutime?

(Nuk ka diskutime.)

Kalojmë në votimin e projektvendimit.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Bledar Bajri: Dakord.

Albens Tabaku: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 244 dhe nr.246, datë 02.05.2024, për kandidaten znj. {...}”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi sipas asaj çfarë u relatua.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ilir Rusi: Në vijim kemi edhe një çështje për të shqyrtuar. Ajo për shkak të karakterit të saj duhet diskutuar me dyer të mbyllura. Njëkohësisht edhe dy anëtarët e sapo ardhur, për shkak edhe të kohës së shkurtër ende nuk janë pajisur me certifikatën e sigurisë. Kështu që mbledhja do të vazhdojë me anëtarët e tjerë prezent në këtë mbledhje.

* * *

(Pika 15 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor